



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri”**

**ofruar nga**

**Universiteti Europian i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Assoc. Majlinda Zahaj**

**Prof. Assoc. Etleva Rustami**

**Nëntor / 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Shkencave në “Infermieri” ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës (UET)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 665, datë 12.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Riorganizuar deri në 20% me Vendim Senati Nr. 5, datë 20.09.2022. Miratuar me shkresë MAS Nr.2484/1 Prot, datë 21.08.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 129, datë 15.07.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 16, datë 25.02.2022 (deri më 24.02.2024)
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite, katër semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 7/2 2023-2024 8/5 2024-2025 9/4
18	Numri i studentëve:	2022-2023 48 studentë 2023-2024 94 studentë 2024-2025 130 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT), në Universitetin Europian të Tiranës (UET).

Universiteti Europian i Tiranës është një institucion privat i arsimit të lartë, i licensuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006; i riorganizuar me VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 dhe i akredituar me VBA Nr. 82, datë 22.09.2023.

FSHMT është hapur me Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 530, datë 04.09.2018.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 665, datë 12.10.2018 si një program universitar i ciklit të dytë dhe e ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2018-2019. Ky program ka kaluar akreditimin e parë me VBA Nr. 16, datë 25.02.2022 dhe ka aplikuar për akreditimin e dytë periodik. Programi është riorganizuar deri në masën 20% (në adresim edhe të rekomandimeve të lëna nga ekspertët e akreditimit), me vendim Senati nr. 5, datë 20.09.2022, miratuar me shkresë të MAS nr 2484/1, datë 21.03.2023. Ndryshimet konsistojnë kryesisht në rritjen e përqindjes së lëndëve karakterizuese të programit në raport me disiplinat e tjera.

Programi MSc në “Infermieri” është një program i ciklit të dytë të studimeve, me kohë të plotë dhe që zhvillohet në gjuhën shqipe. Është i shtrirë në dy vite akademike me nga dy semestra secili dhe ka në total 120 kredite.

Programi ndërthur njohuritë teorike me praktikën infermierore si dhe me kërkimin shkencor në fushën e infermieristikës, duke ofruar një formim shkencor bashkëkohor dhe arsim cilësor dhe duke i aftësuar profesionistët e rinj për hyrjen me sukses në tregun e punës. Gjithashtu në përfundim të këtij programi studentët kanë mundësi të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë apo të angazhohen në drejtim e menaxhim shëndetësor si dhe në fushën akademike.

Realizimin e objektivave të veta ky program e bazon në angazhimin e një stafi profesionist me tituj e grada, në përdorimin e një literature cilësore bashkëkohore dhe në bashkëpunimin e ngushtë me aktorët e tregut të punës për profesionin e infermierit.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në “Infermieri”, që ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Universitetin Europian të Tiranës, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti Europian i Tiranës, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 22 dhe 23 prill 2025.

GVJ përbëhet nga dy ekspertët e vlerësimit të jashtëm **Prof.As. Majlinda Zahaj dhe Prof.As. Etleva Rustami**, të shoqëruar nga Koordinatori Teknik i ASCAL Msc. Arbri Ndreka.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL ditën e parë u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe të Njësisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvillua vizita në sekretarinë mësimore si dhe në ambientet e Fakultetit.

Gjatë vizitës në Fakultet u panë auditorë, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka.

Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara në agjendë dhe nuk kishte ndryshime.

Ditën e dytë, GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ku diskutoi mbi çështje të ndryshme ndërsa më pas zhvilloi një takim ku merrnin pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni, përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të NJSBC. Në fund të takimeve, GVJ vizitoi dhe bibliotekën qendrore të UET. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.16, datë 25.02.2022, "Për akreditimin e parë të programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri" të Universitetit European të Tiranës, janë si vijon:

1. Institucioni, të rekrutojë e angazhojë në këtë program studimi, personel akademik me tituj e grada, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, për programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave.
2. Institucioni, të marrë masa që, fusha e ekspertizës e personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi, të jetë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë.
3. Institucioni, të zbatojë kuadrin ligjor në fuqi, duke shmangur angazhimin në këtë program studimi të personelit akademik me kohë të plotë, të dypunësuar.
4. Institucioni, të rekrutojë staf akademik me kualifikimin e përshtatshëm, për ofrimin e praktikave klinike në këtë program studimi.
5. Institucioni, të pasurojë fondin bibliotekës me literaturë dhe materiale të nevojshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, në funksion të këtij programi studimi.
6. Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e krediteve për lëndët e formimit karakterizues duke rritur peshën e tyre në raport me lëndët e kategorive të tjera formuese.
7. Institucioni, të marrë masa që të gjithë studentët e këtij programi studimi, të realizojnë praktikën mësimore në qendra shëndetësore me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.
8. Institucioni, të mbështesë kualifikimin e vazhdueshëm dhe aktivitetin kërkimor-shkencor të personelit akademik të këtij programi studimi, duke i nxitur ata të publikojnë në revista ndërkombëtare me faktor impakti.
9. Institucioni, të hartojë analiza vjetore në lidhje me ecurinë dhe cilësinë e programit të studimit.
10. Institucioni, të marrë masa që, provimet e studentëve të këtij programi studimi, të kontrollohen nga një komision i përbërë nga dy ose më shumë anëtarë.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni:

1. Institucioni ka rekrutuar si staf akademik efektiv në programin MSH në "Infermieri" 1 personel akademik të kategorisë Prof. Dr., 3 personel akademik të kategorisë Prof. As. dhe 4 të kategorisë PhD/Dr. Gjithashtu, Institucioni ka angazhuar si staf akademik me kontratë, 1 personel të kategorisë PhD dhe një në proces doktorature. Gjithashtu në këtë program studimi janë angazhuar edhe tre mjekë me specializime afatgjata. Pra, në përputhje me nenin 59 pika 6, të Ligjit

80/2015, në këtë program studimi janë angazhuar në masën 90% personel akademik me kualifikim së paku të ciklit pasardhës. Pra, rekomandimi është plotësuar kryesisht.

2. Fusha e ekspertizës së pjesës më të madhe të personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi është në përputhje me lëndët që mbulojnë. Por vlen të theksohet që ka mungesë të stafit akademik efektiv me ekspertizë në fushën e infermierisë për të mbuluar lëndët me karakter infermieror, shumica e të cilave kanë titullarë mjekë. Pra, rekomandimi është plotësuar pjesërisht.
3. Në përputhje me nenin 64 pika 2, të ligjit 80/2015, referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga burimet njerëzore, pedagogët e angazhuar me kohë të plotë në programin MSH në "Infermieri" nuk janë të punësuar në asnjë institucion tjetër me kohë të plotë, por vetëm me kohë të pjesshme. Rekomandimi është përmbushur plotësisht.
4. Departamenti ka caktuar një koordinator për mbikqyrjen e praktikave, i cili është anëtar i stafit efektiv të departamentit me formim infermieror. Ky koordinator bashkëpunon me mbikqyrësit e praktikave që janë kryeinfermierë në institucionet shëndetësore ku zhvillohen praktikat, me të cilët UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Rekomandimi është përmbushur plotësisht.
5. Literatura bazë dhe suplementare në të gjitha lëndët e ofruara në këtë program studimi është e ndërthurur midis literaturës së huaj të botuar nga shtëpi botuese prestigjioze dhe literaturës në gjuhën shqipe. Gjithashtu vihet re pasurim i literaturës me botime të 5 viteve të fundit krahas literaturës më të vjetër. Studentët e aksesojnë këtë literaturë kryesisht në mënyrë digjitale. Institucioni vendos në dispozicion të studentëve bibliotekat on-line ku është abonuar. Ndërkohë lista e librave që ndodhen fizikisht në bibliotekë përbëhet nga botime shumë të vjetra. Rekomandimi është përmbushur kryesisht.
6. Me vendimin Nr. 5 të Senatit Akademik të UET të datës 20.09.2022 "Për miratimin e ndryshimeve në kurrikulat e programeve të ciklit të parë dhe të dytë, dhe programeve me karakter profesional nën masën 20% të përmbajtjes të shprehur në kredite", Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka shtuar peshën e lëndëve karakterizuese (konkretisht 66 kredite nga 60 që ishin), në raport me lëndët e disiplinave të tjera. Gjithashtu, në funksion të thellimit të njohurive për një student të Programit Master i Shkencave në "Infermieri" janë rikonceptuar një pjesë e lëndëve të ofruara nga ky program. Rekomandimi është përmbushur.
7. Studentët e programit MSH në "Infermieri" i zhvillojnë praktikat mësimore vetëm në institucione shëndetësore brenda dhe jashtë vendit me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje zyrtare. Rekomandimi është përmbushur.
8. Institucioni ka një praktikë të konsoliduar për mbështetjen dhe nxitjen e kualifikimeve të stafit, nëpërmjet ofrimit të bursave për ciklin e tretë të studimeve. Gjithashtu për fitimin e titujve akademike institucioni ofron një grant të paracaktuar. Një tjetër shtysë për kualifikimin dhe trajnimin e stafit përbëjnë



mobilitetet në kuadër të programit Erasmus+ me Universitetet partnere të UET, nëpërmjet të cilave pedagogët marrin pjesë jo vetëm në trajnime e mësimdhënie, por edhe në projekte ndërkombëtare. Një mundësi e mirë për publikime shkencore për stafin e UET është edhe Revista "Medicus". **Rekomandimi është përmbushur.**

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion u konstatua se ky i fundit analizon në mënyrë periodike ecurinë e programit të studimit në të gjitha aspektet. Gjithashtu Drejtuesi i Departamentit harton periodikisht (**një herë në dy-tre vjet**) analizën mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit për programin e studimit, analizë e cila duhet të jetë e përvitshme bazuar në ligjin 80/2015. **Rekomandimi është përmbushur kryesisht.**
10. Rekomandimi është përmbushur plotësisht pasi komisioni i provimeve në programin MSH në "Infermieri" përbëhet minimalisht nga dy anëtarë.

Më datë 29.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/34 Prot., datë 27.10.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 07.11.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.186/4 Prot., datë 05.11.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin:

GVJ pasi u njoh me komentet e UET mbi Draft - Raportin, sqaron si më poshtë:

-Komenti lidhur me Standardin I.1 Kriteret 2 dhe 3: - GVJ ka konstatuar se, si Statuti edhe Manuali i Cilësisë të vendosura në dispozicion si referenca nga institucioni, evidentojnë të gjitha njësitë që mbulojnë fushat e tjera të studimit të programeve që ofron ky institucion, përveç njërive që ofrojnë MSH "Infermieri". Na vjen mirë që institucioni ka reflektuar duke miratuar në datën 30.06.2025 shtojcën nr 1 të statutit ku është evidentuar edhe fusha e shëndetit. Por ne jemi bazuar në evidencat e vendosura në dispozicion deri në momentin e vlerësimit.

**Komentet nuk merren parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin I.3 Kriteri 1: - GVJ sërish mendon që analiza e punës në çdo njësi të IAL-së duhet të jetë vjetore dhe e protokolluar.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin I.3 Kriteri 3:- GVJ, sërish mendon se Lista e marrëveshjeve duhet të përfshijë marrëveshjet që janë në fuqi për periudhën e vlerësimit, jo marrëveshjet që u ka mbaruar afati përpara kësaj periudhe.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**



-Komenti lidhur me Standardin II.1 Kriteri 1: - Na vjen mirë që konstatimet tona janë marrë parasysh menjëherë, por GVJ ka bërë konstatime bazuar në evidencat e vendosura në dispozicion deri në momentin e vlerësimit.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin II.3 Kriteri 2:- *Ky koment u mor parasysh dhe konstatimi u hoq, Raporti ndryshon.*

-Komenti lidhur me Standardin II.3 Kriteri 3: - Konstatimi ka lidhje me evidencat ku GVB ka mbështetur plotësimin e kriterit. Vendimi i Senatit që citohet në koment nuk është pjesë e evidencave.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin II.3 Kriteri 4:- Problematika e konstatuar nga GVJ nuk është përgjithësuar për të gjitha syllabuset e programit të studimit.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin II.6 Kriteri 4:- GVJ është bazuar në evidencat e vendosura në dispozicion deri në momentin e vlerësimit në të cilat nuk ishte dokumenti 7 datë 14.05.2025. Ky konstatim u pohua edhe gjatë takimit në institucion nga drejtuesja e zyrës së projekteve.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin III.1 Kriteri 3:- Linqet përkatëse të referuara në koment duhej të ishin vendosur te evidencat.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin III.1 Kriteri 4:- Pavarësisht sqarimeve në koment, konstatimi i GVJ qëndron.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me standardin III.4 Kriteri 4:- *Komenti u mor parasysh dhe konstatimi u hoq, Raporti ndryshon.*

-Komenti lidhur me Standardin IV. 1 Kriteri 2: - GVJ, mendon se ngarkesa mësimore në këtë program studimi, ka numër të madh kreditesh në lidhje me teorinë, ndërkohë që jemi konsistent, se stafi duhet të ketë mbaruar studimet në fushën përkatëse.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin IV. 2 Kriteri 5: - GVJ i është referuar dokumentacionit në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Komenti lidhur me Standardin IV. 3 Kriteri 5: - GVJ, mendon se nuk është e nevojshme që të përcaktohet me ligj gjuha në të cilën duhet të jetë literatuara bazë, kjo mendojmë që padiskutim duhet të jetë Shqip, për sa kohë që programi ofrohet në këtë gjuhë.

**Komenti nuk merret parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

-Koment 11 lidhur me Standardin IV. 5 Përsa i përket raportimit të mbarëvajtjes së Financave GVJ, mendon se është i qartë në atë që sqaron në koment UET.

**Komentet nuk merren parasysh dhe raporti nuk ndryshon.**

**Koment 12 lidhur me Standardin VI. 3 Kriteri 4.** - GVJ, bëri një rregullim të një lapsusi në lidhje me nga “Bordi Këshëllimor i Biznesit”, në “Bordi i Tregut të Punës”

**Komentet merret parasysh dhe në raport ndryshon emri në lidhje me Bordin.**

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti European i Tiranës (UET) është një institucion privat i arsimit të lartë i hapur me VKM Nr.636, datë 20.09.2006, i riorganizuar me VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 dhe akredituar me VBA Nr. 82, datë 22.09.2023. UET përbëhet nga 5 fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat humane, ekonomike, mjekësore, inxhinierike dhe juridike. Programet që ofron ky institucion janë në përputhje me vizionin dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit (Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026) dhe kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>[evidenca nr. 3-Plani Strategjik i UET 2021-2025]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” i ofruar nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është hartuar në përputhje me qëllimet dhe vizionin e institucionit <i>[evidenca nr. 3-Plani Strategjik i UET 2021-2025]</i> , si dhe me fushat e veprimtarisë së Institucionit. <i>(por nuk është e pasqyruar fusha e veprimtarisë në Statutin e UET dhe as në Manualin për Sigurimin e Cilësisë)</i> <i>[evidenca nr.2- Statuti i UET]</i> <i>[evidenca nr.30.2- Manuali për Sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje të Strategjisë për Zhvillim <i>(Plani Strategjik i UET)</i> , <i>por fusha e studimit të këtij programi nuk është e pasqyruar në statutin e institucionit.</i> <i>[Evidenca nr.2-Statuti i UET]</i> Ky program ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në përputhje me rregulloren e institucionit <i>[evidenca nr.5-Rregullore e UET]</i> , rregulloren e këtij programi <i>[evidenca nr.7-Rregullore e MSH Infermieri]</i> si dhe në përputhje me Planin Strategjik për

	Zhvillimin e Programit të Studimit MSc në “Infermieri”. [evidenca nr.4-plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH]			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi MSc në “Infermieri” ka një ndërthurje të formimit teorik me aftësimin praktik duke i mundësuar studentëve aftësimin e tyre profesional e shkencor për të qënë konkurent në tregun e punës. Bazuar në RVB ky program është hartuar dhe zhvilluar duke u bazuar në strategjitë kombëtare të zhvillimit duke pasqyruar interesin kombëtar dhe duke u përshtatur me prirjet globale të zhvillimit. [Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, e cila mungon si evidencë]			
<b>Konkluzione</b>	UET është një Institucion privat i Arsimit të Lartë që ofron programe studimi përfshirë MSc në “Infermieri” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave kombëtare. Programet që ofron ky institucion janë në përputhje me Rregulloren dhe Planin Strategjik të Institucionit, por fusha e studimit e programit MSH në Infermieri duhet të pasqyrohet edhe në Statutin e UET.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UET është një IAL i akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë me vendimin e BA nr. 82, datë 22.09.2023 dhe nga Agjencia Britanike “Quality Assurance Agency for HEI” - QAA [evidenca nr. 54.5- certifikatë akreditimi UET] Institucioni ka një përvojë mbi 5-vjeçare në ofrimin e këtij programi dhe të programeve të tjera të kësaj fushe. Në bazë të dokumentit të hapjes, UMASR Nr. 665, datë 12.10.2018, veprimtaria akademike për këtë program fillon në vitin akademik 2018-2019. Akredituar me VBA Nr. 16, datë 25.02.2022, me kohëzgjatje 2 vite. [evidenca nr. 54-Urdhër nr 665, datë 12.10.2018 Për Hapjen e Programit Msc në Infermieri, evidenca nr. 54.6-VBA nr. 16, datë 25.02.2022 Për Akreditimin e parë MSH Infermieri, UET]

	<p>Njësia kryesore që ofron këtë program studimi, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, ka burimet e duhura në fushën akademike specifike, pra në fushën e shëndetit. Ky fakultet për vitin 2024-2025, ka 22 staf akademik efektiv, shumica e të cilëve me formim shëndetësor, nga të cilët 2 janë të kategorisë Prof. Dr., 5 të kategorisë Prof.As., 4 të kategorisë Lektor (Dr/PhD), 9 në proces doktorature dhe 2 Msc. Gjithashtu, FSHMT ka 7 staf akademik me kontratë nga të cilët 1 me gradën shkencore Dr., 1 në proces doktorature dhe 5 MsC. Nga këta, në njësinë bazë që ofron programin, pra në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë ka 7 staf akademik efektiv dhe 4 me kontratë, 5 prej të cilëve janë me tituj akademikë dhe grada shkencore. <i>[evidenca nr.23-Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse]</i></p> <p>Për realizimin e praktikës mësimore e profesionale të studentëve UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe private si Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” etj. <i>[evidenca nr. 34- marrëveshjet e bashkëpunimit-lista UET, evidenca nr. 35-raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit DIF]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit MSc në “Infermieri”, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, i cili ofron tre programe bachelor, përkatësisht në Infermieri, Fizioterapi dhe Imazheri dhe tre programe të ciklit të dytë MSc në “Infermieri”, MSc në “Fizioterapi” dhe MSc në “Imazheri”. <i>[evidenca nr. 26-të dhëna për nr. e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse]</i></p> <p>Gjithashtu përputhshmëria e fushës së kërkimit evidentohet edhe në përfshirjen e këtij programi në një nga projektet e mëdha kërkimore (PMK) dhe konkretisht “Sfidat dhe e ardhmja në fushat mjekësore”, që përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET në zbatim të Strategjisë së Kërkimit Shkencor në UET 2021-2025. <i>[evidenca nr. 43.2-PMK 2021-2025 dhe evidenca nr. 3.1-Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025]</i></p> <p>Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL-të <i>[evidenca 31.4-njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet</p>	<p>Programi i Studimit MSc në “Infermieri”, ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë (DIF) fusha e veprimtarisë e të cilit përputhet me atë të programit të studimit.</p>

të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ky departament ofron gjithashtu programin bachelor në “Infermieri”. Niveli i njohurive që ofron programi MSc në “Infermieri” përkon me nivelin 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve [evidenca 31.4-njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit]			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Kriteri nuk aplikohet.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në takimin me stafin dhe alumnin gjatë vizitës në institucion u evidentua se nëpërmjet leksioneve të hapura apo aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me punëdhënësit, u krijohet mundësi ish-studentëve të konsultohen në lidhje me karrierën dhe orientimin në tregun e punës. [vizita në institucion]			
<b>Konkluzione</b>	Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Programi MSc në “Infermieri”, ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në UET. Institucioni ka të përcaktuara qartë në rregulloren e tij deyrat për secilën prej strukturave përbërëse. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e këtij programi është e shprehur edhe në Rregulloren e programit të studimit MSc në “Infermieri”, si dhe në Dokumentin

<p>detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>F. IV.-F.V. mbi organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit si dhe në Vendimin e Dekanit për emërimin e koordinatorit të programit të studimit. [evidencat nr. 6-dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit, evidenca nr. 7- Rregullore e MSH Infermieri, evidenca nr. 36-Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</p> <p>Bashkëpunimi dhe realizimi i detyrave të strukturave përgjegjëse brenda dhe midis njësisë bazë dhe kryesore analizohen çdo 2-3 vjet në analizën vjetore të punës së njësisë bazë. [evidenca nr. 38-Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit dhe takimi me Drejtuesen e Departamentit dhe Dekanen]</p> <p><b>Por, analiza e punës së departamentit duhet të jetë e përvitshme dhe e protokolluar (neni 32 i Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore homologe si dhe me operatorë në fushën e shkencave mjekësore teknike, vendas e të huaj, me karakter publik apo privat. Këto marrëveshje kanë për qëllim realizimin e praktikës mësimore e profesionale, organizimin e trajnimeve, realizimin e kërkimit shkencor, shkëmbimit të ekspertizës, punësimit të studenteve, etj.</p> <p>[evidenca nr. 34-marrëveshje bashkëpunimi-lista UET] [evidenca nr. 35-raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit DIF]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit MSc në “Infermieri”, UET ka lidhur memorandume të posaçme dhe marrëveshje bashkëpunimi me qendra spitalore dhe klinika të ndryshme që ndihmojnë studentët të zhvillojnë praktikën profesionale, realizimin e temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimin e kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunitorëve janë punëdhënësit të drejtpërdrejtë [referenca nr. 34- marrëveshje bashkëpunimi-lista UET dhe referenca nr 32-lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale], por një pjesë e tyre janë marrëveshje të cilave u ka përfunduar afati dhe nuk janë funksionale. (p.sh. marrëveshja me Q.S.U. “Nënë Tereza” e cila është në krye të listës dhe nuk është aktive sipas evidentimit edhe në vizitën në institucion).</p>

kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Zyra e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit mban komunikim të vazhdueshëm me këto institucione për të garantuar akomodimin e studentëve. Gjithashtu studentëve u caktohet një pedagog mbikqyrës i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës në institucionin pritës dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga studentët. Një pjesë e pedagogëve të lëndëve të këtij programi mentorojnë studentët në vëndet e punës ku ata punojnë. (shembull interesant bashkëpunimi në këtë drejtim është ai me Qëndrën Spitalore Universitare Obstetrikë-Gjinekologjike “Koço Glozheni”, sipas përshkrimit edhe në takimin me stafin)			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në mënyrë periodike harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit [evidenca nr. 35-raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit DIF] Gjithashtu një model i mirë për evidentimin e përfitimit të studentëve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të praktikave profesionale e ndërlyndore është dosja e studentit për praktikat respektive me formularët tip të vlerësimeve. [përkatësisht evidenca 32.4-dosje studenti praktike profesionale dhe evidena nr. 32.5-dosje studenti praktike ndërlyndore]			
<b>Konkluzione</b>	UET siguron marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore e shëndetësore si dhe me kompani e palë të treta në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor e mobilitetit, por duhet që lista e marrëveshjeve të përditësohet dhe analiza e punës të jetë e përvitshme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
---	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË




<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSc në “Infermieri” është i ndërtuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë sipas nivelit 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe organizohet në 120 ECTS, kohëzgjatje dy vite akademike (60 kredite për vit) të ndarë në dy semestra për çdo vit, në total 4 semestra. Programi është i organizuar në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E dhe përqindja e krediteve që i takojnë secilës kategori është në përputhje me Vendimin e MAS nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Syllabuse-t e lëndëve janë ndërtuar sipas të gjithë elementëve të përcaktuar në vendimin e mësipërm, <i>përveç faktit që temat e leksioneve nuk janë të ndara sipas javëve dhe në disa syllabuse, literatura për çdo temë nuk është e detajuar me faqe, konform vendimit nr.41.</i>  <i>[evidenca nr.19-syllabuse shqip dhe evidenca nr. 19.1.1.-formati i syllabusit, shqip-anglisht, VKM 41-2018]</i>  <i>Ka edhe një devijacion tjetër të lehtë nga kjo VKM, pasi përqindja e orëve të punës së pavarur të studentit është 49.5%, ndërkohë që duhet të jetë jo më e vogël se 50% dhe konkretisht 1487 orë punë e pavarur kundrejt 1513 orë në auditor</i>  <i>[evidenca nr. 14.2-plani mësimor i programit]</i>            Studimet përmbyllet me temë diplome (18 kredite) në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë neni 75, pika 5.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme</p>	<p>MSc në “Infermieri” si një program i ciklit të dytë të sudimeve synon të thellojë njohuritë bazë të fituara në programin bachelor si dhe të zhvillojë aftësi dhe kompetenca të avancuara si në fushën profesionale (kryesisht nëpërmjet lëndëve karakterizuese të specialiteteve të ndryshme të programit, një pjesë të lëndëve integruese dhe me praktikën profesionale), por edhe në fushën akademike (me lëndë të tilla si “Metoda Kërkimi në Shkencat Mjekësore” apo “Punimi i Diplomës”).            Gjithashtu një vend të rëndësishëm në kurrikul zë edhe përgatitja e studentëve për drejtim e menaxhim (nëpërmjet lëndëve të tilla si “Menaxhim Shëndetësor”, “Menaxhim Strategjik i Burimeve Njerëzore” apo “Komunikimi, Etika dhe Lidhshipi në Organizatë” etj. <i>[evidenca nr. 14.2-Plani mësimor i programit]</i></p>

<p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar edhe në informacionet e marra nga takimi me studentët, gjatë dhe mbas përfundimit të këtij programi, nëpërmjet orëve në auditor apo kryerjes së praktikave profesionale, ata kanë fituar njohuri të përparuara në fushën e shëndetit dhe komunikimit dhe e ndjejnë veten të aftë si për t'i shërbyer pacientëve me etikë dhe profesionalizëm, ashtu edhe në zgjidhjen e situatave komplekse. Një pjesë e tyre shprehën synimet për të vazhduar me kontributin e tyre në botën akademike falë formimit akademik të përfituar nga ky program. <i>[takimi me studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi e ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale e cila është e ndarë në praktikë profesionale I (vitin e parë) dhe praktikë profesionale II (vitin e dytë) me nga 6 kredite secila. Gjithashtu në secilin vit janë të grupuara edhe praktikatat ndërlëndore, tre të tilla me nga 6 kredite secila duke e çuar në 30 numrin total të krediteve që i takojnë formimit praktik të studentëve në funksion të një aftësimi sa më të mirë profesional të tyre dhe hyrjes me sukses në tregun e punës. <i>[evidenca nr.14-Kurrikula e programit MSH Infermieri, evidenca nr.14.2- Plani mësimor i programit dhe evidenca nr.14.4-Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese].</i></p> <p>Praktikat zhvillohen në disa nga qendrat spitalore universitare më të mëdha në Shqipëri si p.sh. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, ku studentët e ndjejnë veten shumë mirë pasi iu mundësohet një përgatitje e plotë dhe e balancuar, gjë që ju jep atyre sigurinë për të kaluar në tregun e punës.</p> <p><i>[evidenca nr. 32-Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikatat profesionale, evidenca nr.35-Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit DIF dhe sipas komunikimit direkt si në intervistën me stafin edhe në intervistën me studentët]</i></p> <p>Gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe detyrimeve përmbyllëse të cilat konform legjislacionit në fuqi mbyllen me mbrojtjen me temë diplome dhe kanë 18 kredite në këtë program. <i>[evidenca nr.14- Kurrikula e programit MSH Infermieri].</i> Mbrojtja bëhet nëpërmjet paraqitjes së një punimi diplome, produkt origjinal i studentit nën udhëheqjen e një pedagogu që zotëron të paktën gradën shkencore doktor dhe vlerësohet me notë si gjithë detyrimet e tjera. <i>[evidenca nr.10-Dokumentit B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>MSc në “Infermieri” është një program studimi me kohë të plotë, forma e organizimit të studimeve të të cilit si dhe pranimi i studentëve është në përputhje me Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit. Përsa i takon financimit, UET është një institucion privat i arsimit të lartë pa ndonjë status të veçantë dhe financimi bazohet kryesisht nga të ardhurat e tarifave të studentëve dhe nga të ardhurat nga projektet ku institucioni merr pjesë. <i>[ligji 80/2015, vizita në institucion]</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Pavarësisht se institucioni referon se ka një përputhshmëri të mirë të programit krahasuar me të tjerë të tillë në nivel kombëtar [evidenca 17], për plotësimin e këtij kriteri, ka nevojë për një unifikim të koordinuar nga MAS. Ky program është hartuar duke zbatuar VKM nr.41, datë 24.1.2018 i ndryshuar. Në zbatim të nenit 86 të Ligjit 80/2015, VKM-së nr 310, datë 11.05.2022 lidhur me kodifikimin e programeve të studimit dhe Udhëzimit të MAS nr.31, datë 15.11.2022, UET i është drejtuar MAS me shkresën me nr. Prot. 60, date 31.03.2023 [evidenca 31.3]</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi MSc në “Infermieri” është program i ciklit të dytë të studimeve, me 120 kredite, i shtrirë në dy vite dhe i referohet kornizës 7 të kualifikimit. Ky program ka kodin 72MS0913S pasi i takon fushës 9 “Shëndet dhe Mirëqënie” sipas konfirmimit nga MAS me shkresën 7381/1, datë 30.12.2024. [evidenca nr. 31.4-Njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit]</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi MSc në “Infermieri” nuk është një program i përbashkët me ndonjë IAL tjetër, por institucioni referon se është i gatshëm për bashkëpunim me IAL të tjera.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe me aktet rregullatore të institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin MSc në “Infermieri” është Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, i cili në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 23, pika 1 bashkërendon mësimdhënien</p>

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe në përputhje me nenin 23 pika 2, 3 organizohet në tre njësi bazë, përkatësisht:

1. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
2. Departamenti i Imazherisë
3. Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik  
[evidenca nr.2-Statuti i UET]

Stafi akademik efektiv dhe stafi akademik me kontratë, për 2 vitet e fundit akademike është si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik i FSHMT	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	2	-	2	-
Prof. Asoc.	5	-	5	-
Dr/Phd	6	1	4	1
Dr. Proces	8	2	9	1
Msc.	3	11	2	5
<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>14</b>	<b>22</b>	<b>7</b>

Njësia bazë që e ofron këtë program studimi është Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, i cili në përputhje me ligjin 80/2015 neni 25, pika 4, për 3 vitet e fundit akademike është sipas tabelës më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të DIF	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
Dr/Phd	2	1	1	1	1	1
Dr. proces	2	1	4	1	2	1
Msc.	2	4	-	8	1	2
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>4</b>

	<p>Gjithashtu sipas nevojave vjetore DIF angazhon edhe personel akademik me kontratë ku për vitin aktual janë 4, prej të cilëve 1 Doktor Shkencash, 1 në proces doktorature dhe 2 Msc. <i>[evidenca nr. 23-të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një procedurë shumë të qartë për realizimin e praktikave mësimore e profesionale, ku specifikohet mënyra e organizimit, zhvillimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit të praktikës, sipas këtij dokumenti dhe sipas intervistës me stafin dhe studentët, departamenti cakton një pedagog përgjegjës, kryesisht këshilltari i karrierës dhe një person përgjegjës në institucionin shëndetësor ku kryhet praktika (kryesisht kryeinfermierë të shërbimeve). <i>[evidenca nr. 32.1-dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale]</i></p> <p>Në këtë program të ciklit të dytë nuk ka orë laboratorit në planin mësimor (përveç dy lëndëve), por vetëm praktika ndërlëndore dhe profesionale që kryhen në institucionet me të cilat FSHMT ka marrëveshje</p> <p><i>[evidencat nr. 14.2-Plani mësimor i programit, evidenca nr. 32.2-Formularët e praktikave, evidenca nr. 32.4-Dosje studenti praktike profesionale, evidenca nr. 32.5-Dosje studenti praktike ndërlëndore].</i></p> <p><b>Megjithatë vihet re një mospërputhje midis planit mësimor (në të cilin nuk ka laboratore) dhe syllabuseve të disa lëndëve (p.sh. Infermieristika e mjekësisë materno-infantile dhe shëndeti riprodhues) për sa i takon veprimtarive të mësimdhënies, pasi në syllabuse ka edhe laboratore.</b></p> <p><i>[evidenca nr.19-syllabuse shqip]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me vendim të Dekanatit të FSHMT datë 14.03.2023 është emëruar koordinorja e programeve të studimit që ofron Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. <i>[evidenca nr. 36-Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit].</i> Në aneksin bashkëngjitur këtij vendimi janë të shprehura qartë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës si për ecurinë dhe zhvillimin e kurrikulës së programit dhe midis të tjerash edhe për ndjekjen e ecurisë së zhvillimit të praktikave profesionale. <i>[aneks i evidencës nr. 36- Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si njësi kryesore dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë si njësi bazë që</i></p>

	<p>ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Infermieri", i përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p> <p>Departamenti duhet të sigurojë përputhjen e çdo syllabus-i me planin mësimor lidhur me shpërndarjen e veprimtarive formuese.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</b></p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion por edhe nga takimet në institucion konstaton se Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë që ofron këtë program studimi zotëron informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të pasqyruara edhe në Rregulloren e këtij programi. [evidenca nr. 7-Rregullore MSH Infermieri].</p> <p>Çdo informacion është i aksesueshëm për stafin dhe studentët nëpërmjet faqes zyrtare të UET sipas RVB dhe vizitës në institucion [evidenca nr.47-Faqja zyrtare e UET], megjithëse nga navigimi ynë konkret në faqen zyrtare të UET, disa informacione lidhur me kurrikulën e programeve, ishin të paaksesueshme (p.sh. plani mësimor i detajuar, apo syllabuset e lëndëve).</p>
<p><b>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</b></p>	<p>Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, vihet re se programi i studimit i përmban të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM nr. 41, date 24.1.2018, i ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Ky program është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe veprimtari formuese.</p> <p>Programi është i organizuar në 5 kategori disiplinash nga A në E, të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Përqindja e krediteve që i takon çdo kategorie është në përputhje me VKM-në e cituar më sipër. [evidenca nr.14.4-Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese]</p> <p>Plani mësimor i këtij programi studimi ka informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore</p>

	dhe kreditet për çdo lëndë si dhe orët në auditor dhe jashtë auditorit. [evidenca nr.14-Kurrikula e programit MSH Infermieri dhe evidenca nr.14.2-Plani mësimor i programit].
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Msc në “Infermieri”, neni 2, janë të detajuara informacionet e nevojshme për kriteret e përgjithshme dhe procedurat e pranimit të studentëve në këtë program studimi. <i>Por mungojnë kriteret specifike, si p.sh thuhet që studenti duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të parë, por nuk janë të specifikuar cilat diploma të nivelit të parë mund të pranohen në këtë program studimi.</i> [evidenca nr.7-Rregullore MSH Infermieri]</p> <p>Gjithashtu procedurat dhe kriteret e përgjithshme të pranimit në programet e ciklit të dytë janë të sqaruara edhe në dokumentin D.I “Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve. [evidenca nr.27.1]</p> <p>Gjithashtu në Rregulloren e programit të studimit , neni 9, janë informacionet mbi procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. [evidenca nr.7-Rregullore MSH Infermieri] Por në mënyrë më të detajuar këto procedura janë në dokumentin D.II “ Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.” [evidenca nr. 28]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një dokument të posaçëm (në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.1.2018), dokumentin A III “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës”, i cili shpreh në mënyrë të detajuar si duhet të ndërtohet syllabusi i çdo lëndë. [evidenca nr. 39-Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës]</p> <p>Syllabusi hartohet në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës dhe pasi konsultohet nga koordinatorja e programit dhe miratohet nga drejtuesja e departamentit, i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet sistemit LMS.</p> <p>Syllabuset përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm duke filluar nga titulli i lëndës, ngarkesa në orë dhe kredite për secilin komponent përbërës (leksione, seminare, etj.), viti dhe semestri kur zhvillohet lëndë, kategoria ku bën pjesë, kodi i lëndës, adresa elektronike e pedagogut të lëndës duke vazhduar më tej me tematikën për çdo komponent përbërës dhe literaturën bazë dhe suplementare si dhe detyrimet e frekuencimit dhe mënyrën e vlerësimit, në përputhje me formatin e miratuar.</p> <p><i>Por ndryshe nga sa e kërkon VKM-ja e mësipërme, literatura e detyruar nuk është e detajuar me numrin e faqeve për çdo temë në të gjitha syllabuset dhe diçka tjetër që bie në sy është se, në një</i></p>

	<i>pjesë të syllabuseve të vendosur si evidencë nuk përputhet shpërndarja e orëve në veprimtaritë formuese të lëndës me atë shpërndarje që ka kjo lëndë në planin mësimor të programit. (shih syllabusin e lëndës Infermieristika e mjekësisë materno-infantile dhe shëndetit riprodhues) [evidencat nr. 19-Silabuse shqip dhe 14.2-Plani mësimor i programit]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Rregullorja e programit të studimit Msc në “Infermieri”, në nenin 10 të saj, ka të parashikuar qartë mënyrën e rishikimit periodik në çdo fillim viti akademik të programit të studimit, rregullores së tij, planit mësimor, lëndëve, veprimtarive formuese dhe krediteve për secilën prej tyre. Propozimi për ndryshim në çdo rast vjen i argumentuar nga pala e interesuar, shqyrtohet në department dhe nga zyra e kurrikulave dhe më tej miratohet në dekanat. [evidenca nr.7-Rregullore MSH Infermieri] [evidencat 52-Procedura për ndryshimin e kurrikulës, tabela 11 dhe 52.1, vendim senati nr.5 datë 20.9.2022 për miratimin e ndryshimeve në kurrikulat e programeve nën 20%.]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit është i detajuar dhe informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë, por ka nevojë për disa përmirësime si p.sh. mospërputhjet që ekzistojnë në ndarjen e orëve sipas veprimtarive formuese në syllabus-in e lëndës dhe në planin mësimor total, apo specifikimi i qartë i literaturës së detyruar me nr faqeje. Gjithashtu në rregulloren e programit të studimit duhet të listohen edhe kriteret specifike të kandidatëve për këtë program (p.sh. cilat diploma të bachelorit mund të ndjekin studimet MSH në Infermieri)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Programi Msc në “Infermieri” është hartuar dhe organizuar në përputhje me kriteret e vendosura edhe në Statutin e institucionit sipas të cilit Masteri i Shkencave synon t’i pajisë studentët me njohuri të thelluara shkencore. [evidenca nr.2-Statuti i UET]

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar kurrikulës dhe planit mësimor të këtij programi vihet re se emërtimi dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë formim të thelluar jo vetëm në specialitete të ndryshme të profesionit të infermierit dhe praktikës infermiore por edhe në drejtim të kërkimit shkencor, të menaxhimit shëndetësor apo komunikimit dhe lidhshimit dhe aspektit psikologjik. <i>[evidencat nr. 14-Kurrikula e programit MSH Infermieri dhe 14.2-Plani mësimor i programit]</i></p> <p>Një organizim i tillë mundëson thellimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të studentëve si për studime të mëtejshme në fushën akademike e shkencore edhe për punësimin në terren.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore në orë/kredite u mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vëndet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së tyre të përditshme. Gjithashtu një pjesë e tyre ndjehen të motivuar për të vazhduar më tej me formimin e tyre akademik dhe të kontribuojnë në formimin e brezave të tjerë të infermierëve. <i>[takimi me studentët]</i> <i>[evidenca nr. 38-Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formues të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Referuar RVB, takimit me drejtuesit, stafin dhe studentët , por edhe informacioneve të GVJ, struktura e programit, raporti teori-praktikë dhe lëndët që ofrohen janë në përputhje me profilin e këtij programi studimi por edhe të ngjashme me programe të tjera kombëtare e ndërkombëtare të të njëjtit profil.</p> <p>Institucioni referon se ky program është hartuar duke shqyrtuar plan-programet e Universitetit “Nostra Signora del Buon Consiglio” dhe “Universita degli Studi di Firenze”, Itali. <i>[evidenca nr. 17-Studimi për tregun e punës], [vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese, raporti në ngarkesën e tyre në kredite bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe raporti teori-praktikë, ndikojnë në arritjen e objektivave formues të programit si dhe në transferimin dhe mobilitetin e studentëve në programe të tjera të ngjashme. Institucioni ka hartuar edhe një rregullore të posaçme për mobilitetin e studentëve, <i>pavarësisht se nuk ka ndonjë evidencë të mobiliteteve të studentëve, por vetëm të</i></p>




<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p><i>stafit. [evidenca 28.1.1-Rregullore për shkëmbimet studentore Erasmus dhe diploma të dyfishta], [vizita në institucion]</i></p> <p>Kurrikula e këtij programi dhe njohuritë e marra u krijojnë mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brënda dhe jashtë vendit, pavarësisht se nga monitorimi i punësimit të studentëve rezulton se për vitet 2021-2022, nga 7 të diplomuar, 3 janë punësuar (pra 43%), ndërkohë që 4 prej tyre nuk kanë kthyer përgjigje. Kurse për vitin 2022-2023 nga 15 të diplomuar, 7 janë punësuar, 6 nuk janë punësuar dhe 2 janë pa përgjigje [evidenca nr. 29-Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Parimet e hartimit të programeve të lëndëve janë të detajuara në dokumentin A.III “Mbi Parimet e Ndërtimit të Programit të Lëndës”. Sipas këtij dokumenti programi i lëndës hartohet nga pedagogu i lëndës, shqyrtohet nga përgjegjësi i grupit mësimor përkatës dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit. [evidenca nr. 39-dokumenti A.III “Mbi Parimet e Ndërtimit të Programit të Lëndës”.]</p> <p>Referuar Rregullores së programit të studimit, por edhe takimit me stafin, programet e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p>Filozofia e UET është përdorimi preferencial i literaturës së huaj, veçanërisht të teksteve bazë të universiteteve ose të botuesve universitarë më prestigjiozë perëndimorë. [evidencat nr. 39-dokumenti A.III “Mbi Parimet e Ndërtimit të Programit të Lëndës”, evidenca nr.19-Syllabuse shqip, evidenca nr.7-Rregullore MSH Infermieri], [vizita në institucion]</p> <p><b>Mirë do të ishte të kishte edhe literaturë shqipe të 5 viteve të fundit e të hartuar nga profesorët tanë të nderuar.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës duke i pajisur studentët me aftësi e kompetenca teorike e praktike të profesionit të infermierit, të menaxhimit shëndetësor dhe gjithashtu të komunikimit e të lidërshiptit. [evidenca nr. 14-Kurrikula e programit MSH Infermieri]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Përmbajtja e programit MSH në “Infermieri” u mundëson studentëve siguri për ushtrimin e profesionit në përshtatje me pritshmëritë e sistemit shëndetësor në vend dhe jo vetëm, por gjithashtu u mundëson vijimin e studimeve të ciklit të tretë të doktoraturës.</p>

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<i>[evidenca nr. 14-Kurrikula e programit MSH Infermieri], [vizita në institucion]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri" është në përputhje me objektivat formuese të infermierit profesionist, nivelin e kualifikimit sipas nivelit të 7-të të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe në përputhje me kuadrin evropian të kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Referuar dokumentit "Mbi studimin për tregun e punës" <i>[evidenca nr.17]</i>, ky program është hartuar dhe rishikohet në bazë të legjislacionit në fuqi, rekomandimeve të akreditimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Bazuar në Statutin e UET programi konsultohet në mënyrë të herë pas herëshme me Bordin e Tregut të Punës (BTP) dhe mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut. <i>[evidenca nr.2-Statuti i UET]</i> Në BTP bëjnë pjesë profesionistë (kryesisht ALUMNI) që sjellin perspektivën e tregut dhe aspektet që nevojitet të punohet më shumë në drejtim të përgatitjes së profesionistëve. <i>[evidenca nr. 12.1-Bordi i tregut të punës DIF, 12.2-Short Bio e anëtarëve të BTP]</i></p> <p>Fakulteti dhe departamenti analizon ecurinë e programeve të studimit duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës, mendimin e stafit akademik dhe të studentëve. Departamenti realizon një ose dy herë në vit takime me BTP për të konsideruar mendimet dhe propozimet e tyre për përmirësimin e kurrikulës së programit, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brëndshme. <i>[evidenca nr. 38-Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit, evidenca nr.12.3-Agjenda e takimit BTP], [vizita në institucion]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UET e ka të sanksionuar në Statut përfshirjen e studentëve në strukturat e institucionit (të tilla si: Senat Akademik, Këshill Etike apo KSBC), me qëllim konsultimin e vazhdueshëm me ta për përmirësimin e programit të studimit dhe për çdo drejtim tjetër të mbarëvajtjes së procesit mësimor. <i>[evidencat nr. 2-Statuti i UET dhe 30-Të dhëna për anëtarët e KSBC], [takimi me studentët]</i></p> <p>Referuar takimit me studentët, departamenti zhvillon një herë në muaj mbledhje të hapur me studentët për vjeljen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe më gjerë.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar në lidhje me punësimin apo vazhdimin e studimeve të tyre në UET apo në institucione të tjera brënda dhe jashtë vëndit. <i>[evidenca nr.12-Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrieres dhe kujdesit ndaj studentit], [takimi me studentët]</i></p> <p>Gjithashtu përbërja e Bordit të Tregut të Punës me të cilin konsultohet programi në mënyrë të herë pas hershme, është krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale në institucionet ku janë punësuar. <i>[evidencat 12.1-Bordi i tregut të punës DIF, 12.2-Short Bio e anëtarëve të BTP, 12.3-Agjenda e takimit BTP]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në përputhje me Statutin e UET <i>[evidenca nr.2]</i> dhe Planin Strategjik për Zhvillimin e programit të studimit Msc në “Infermieri” <i>[evidenca nr. 4]</i>, garanton përmirësimin e vazhdueshëm të programit, në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit, duke u konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me Bordin e Tregut të Punës, me përfaqësues të shërbimeve shëndetësore publike e private, Urdhrin e Infermierit, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë zhvillimeve të fundit në fushën e shëndetit. <i>[evidenca nr. 12.3-Agjenda e takimit BTP]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i përfshin në mënyrë të vazhdueshme studentët, alumnit dhe partnerët që ofrojnë shërbim shëndetësor në sektorin publik dhe privat, si dhe Urdhrin e Infermierit në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin e objektivave të formimit.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në pikën 3.3 të Rregullores së programit të studimit MSH në “Infermieri” përcaktohen qartë objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor të këtij programi. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i> Gjithashtu objektivat dhe prioritetet e këtij programi studimi janë të shprehura qartë edhe në pikat II dhe III të Planit Strategjik për zhvillimin e programit të studimit. <i>[evidenca nr.4-Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH]</i> Këto objektiva dhe prioritete të këtij programi studimi janë në përputhje me objektivat madhore të institucionit të paraqitura në nenin 6 të Statutit të UET <i>[evidenca nr. 2]</i> si dhe në Planin Strategjik të UET 2021-2025. <i>[evidenca nr. 3]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	FSHMT dhe DIF bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por duke respektuar lirinë akademike dhe fushën e veçantë të studimit të personelit akademik. Kjo vihet re p.sh. në organizimin apo rishikimin e përbajtjes së lëndëve ku sipas dokumentit A.III “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës”, pika A.III.11.1, thuhet: “Programi i lëndës hartohet nga pedagogu i lëndës, shqyrtohet nga përgjegjësi i grupit mësimor përkatës dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit”, ose pika A.III.11.2 thotë: “pedagogu mund të propozojë shmangie nga formati i miratuar që duhet të diskutohen në grupin mësimor dhe department, të miratohen me vendim të dekanatit dhe të pasqyrohen në programin e lëndës. <i>[evidenca nr. 39-Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës]</i> Motivimi dhe inkurajimi i vazhdueshëm i stafit për kërkim shkencor individual ose në grup sipas fushës së veçantë të studimit, është e shprehur në pikën 2 të Planit Strategjik për zhvillimin e programit të studimit, <i>(Prioritetet për kërkimin shkencor)</i> <i>[evidenca nr.4]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të	Studentët e programit MSH në “Infermieri” angazhohen në kërkimin shkencor nëpërmjet disa mënyrave si:

angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimit të detyrave të kursit të parashikuara në syllabuset e lëndëve dhe ka 20% të vlerësimit [evidencat nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri dhe nr. 19-Silabuse shqip]</li> <li>- Realizimit të punimit të diplomës i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit sipas pikës 8 të Rregullores së programit të studimit. [evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</li> <li>- Pjesëmarrjes si dëgjues apo duke prezantuar punimet e tyre në aktivitete shkencore si konferenca “Ditët e Studimit Shqiptar Junior” [evidenca nr. 56-DSSH junior 2021-2024],[takimi me studentët]</li> </ul> <p>Por nuk ka evidencë të angazhimit të studentëve në projekte.</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>Aktiviteti kërkimor në UET financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brëndshme dhe donacionet. UET mbështetet në fondet e përfituara përmes Zyrës së Projekteve dhe partneriteteve për financimin e zgjerimit të kërkimit shkencor ndërdisiplinor që përputhet me qëllimet e financuesve dhe partneriteteve strategjike të UET.</p> <p>Por deri tani, me gjithë arritjet shumë të mira të UET në këtë aspekt përse i takon fushave të tjera, nuk ka asnjë projekt në fushën e shëndetit ku të jetë i përfshirë edhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. [takimi me Drejtuesen e Zyrës së Projekteve UET]</p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit Msc në “Infermieri” garanton orientimin në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor si për stafin edhe për studentët. Duhet përpjekje më të mëdha të institucionit për të përfshirë edhe këtë program në projekte gjithëpërfshirëse.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për	Referuar Strategjisë së Kërkimit Shkencor UET 2021-2025, Projektet e Mëdha Kërkimore (PMK) përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET dhe projekti me anë të të cilit ndërtohet dhe realizohet kërkimi shkencor në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë është “Sfidat dhe e Ardhmja në Fushat Mjekësore”.

<p>realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>[evidenca nr. 3.1- Strategjisa e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025]</p> <p>Gjithashtu FSHMT ka marrëveshje me struktura spitalore universitare, por edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë për realizimin e punës kërkimore shkencore dhe plotësimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. [evidencat 34-Marrëveshje bashkëpunimi-lista UET, 35-Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit DIF]</p> <p>Infrastruktura ndihmëse për kërkimin shkencor janë edhe laboratorët e kompjuterëve dhe biblioteka e pasur me literaturë fizike (e cila është relativisht e vjetër) dhe abonime shkencore periodike. [evidencat nr. 45-Inventari i teksteve në bibliotekë për fushën e studimit të programit MSH Infermieri dhe 45.3-Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti angazhon personelin dhe studentët për realizimin e studimeve dhe projekteve kërkimore-shkencore. Grupet drejtuese të PKM-ve janë një mekanizëm i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor, pasi vendosin për punimet që pranohen në DSSH dhe orientojnë kërkimin shkencor të Junior Researchers që përfshihen në këto projekte.</p> <p>[vizita në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>DIF në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të UET organizon konferenca, seminare, work-shope dhe aktivitete të tjera në bashkëpunim dhe me institucionet shëndetësore partnere, të cilat ndihmojnë si personelin akademik edhe studentët për arritjen e objektivave shkencore. Një nga veprimtaritë shkencore periodike që organizohet është “Ditët e Studimeve Shqiptare”, gjatë së cilës shkëmbehen idetë dhe përvojat e mjekëve specialistë dhe akademikëve, jo vetëm shqiptarë por dhe të huaj. [evidenca nr. 55-Ditët e studimeve shqiptare DSSH 2021-2024 ] Në këtë konferencë një vënd të veçantë zënë punimet e përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve. [evidenca nr.56-DSSH junior-2021-2024], [takimi me stafin dhe studentët]</p> <p>Një tjetër mundësi e krijuar nga institucioni për arritjen e objektivave shkencore është botimi i revistës “Medicus”, e cila u jep mundësinë kërkuesve shkencorë të publikojnë punimet e tyre shkencore origjinale në gjuhën angleze.</p> <p>[vizita në institucion]</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Nëpërmjet një kurrrikule të ndërtuar mbi baza ligjore dhe sipas kërkesave të tregut të punës, përmes një angazhimi serioz në realizimin e objektivave të studimit dhe të kërkimit shkencor, si dhe nëpërmjet një bashkëpunimi të pandërprerë me institucionet shëndetësore, infermierët e formuar në këtë program studimi janë profesionistë të aftë dhe konkurrues si në tregun kombëtar dhe në atë ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>[evidenca nr.14-Kurrikula e programit MSH Infermieri dhe takimi gjatë vizitës në institucion me aktorë të institucioneve shëndetësore ku kryhen praktikat dhe punësohen të diplomuarit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Rekomandimet e nxjerra nga Urdhri i Infermierit pasqyrohen në aktet ligjore lidhur me kompetencat e nevojshme për liçensimin e infermierëve dhe FSHMT zbaton aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i>[takimi me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore gjatë takimit në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Infermieri” është në përputhje me aktet ligjore në vend për profesionet e rregulluara dhe me rekomandimet ndërkombëtare.</p> <p>Por nga takimi me drejtuesit gjatë vizitës në institucion, u konstatua që ende nuk kishin filluar nga puna për zbatimin e VKM nr. 823, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.41, datë 24.01.2018, të KM, ‘Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.”</p> <p><i>[takimi me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore gjatë takimit në institucion]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Msc në “Infermieri” garanton njohuri të thelluara në fushën e infermieristikës, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar dokumentit A.III “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës” dhe të formësuar në planin mësimor të programit të studimit Msc në “Infermieri”, format e mësimdhënies dhe transmetimit të njohurive në këtë program janë leksionet, seminarët, punët laboratorike (në planin mësimor vetëm dy lëndë kanë edhe laboratore), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor, praktika profesionale, provimet e ndërmjetme/përfundimtare dhe punimi i diplomës. [evidencat 39-Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës, 14.2-Plani mësimor i programit]</p> <p>Kontrolli i vazhdueshëm i dijeve gjatë gjithë semestrit është një formë shumë e mirë që u jep mundësi studentëve të dalin me rezultate sa më cilësore.</p> <p>Gjithashtu departamenti organizon edhe leksione të hapura, si një nga format e transmetimit të njohurive dhe angazhimit në kërkimin shkencor. [evidenca nr.43-Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit DIF 21-24]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentin A.III “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës”, rubrika A.III.4.2.2 “Metodat pedagogjike”, pedagogu përveç formave klasike të mësimdhënies, shton në mënyrë të konsiderueshme metodat e mbështetura në kodet vizive, audio si edhe puna e pavarur dhe të nxënit jashtë auditorit, apo ndërhyrjet që bëhen nga specialistët e praktikës. [evidenca nr. 39- Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës]</p> <p>Gjithashtu angazhimi për krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre</p>

	<p>akademike sanksionohet edhe në Rregulloren e UET neni 27.3 [evidenca nr.5-Rregullore e UET]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Një nga mënyrat për sigurimin e brendshëm të cilësisë parashikuar në dokumentin F.VII “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë” lidhet me trajnimin e pedagogëve. [evidenca nr.8]</p> <p>UET siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik nëpërmjet aktiviteteve periodike të tilla si: “Staff Development Day”, që synon trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë.</p> <p>Referuar takimit në institucion është zhvilluar trajnimi për Learning outcomes “Methodological training” dhe provimi për personelin akademik “Student centred learning”. Në fillim të vitit akademik, universiteti organizon trajnimin dyditor “Back to work”. [sipas takimit në institucion, por nuk ka evidencë shoqëruese për këto aktivitete]</p> <p>Gjithashtu një pjesë e stafit akademik kanë përfutuar nga praktikat më të mira ndërkombëtare të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes, nëpërmjet programeve të shkëmbimit me universitetet partnere (Erasmus +KA1) [evidenca 43.1-Raporti i mobiliteteve staf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit MSH në “Infermier”, zotëron tituj dhe grada shkencore si dhe ekspertizë profesionale në lëndët ku janë titullarë. <i>Por pavarësisht faktit që këta titullarë janë mjekë profesionistë të shkëlqyer, shumica e lëndëve karakterizuese të programit, që natyrisht, janë me karakter infermieror, nuk ka titullarë me formim infermieror.</i> [evidencat nr. 19-Silabuse shqip, 20-CV e stafit akademik të programit të studimit, 24-Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite]. [Në takimin me Dekanen dhe Drejtuesen e Departamentit, kjo mangësi u argumentua me mungesën e stafit infermieror me tituj e grada shkencore]</p> <p>Personeli akademik përdor një ndërthurje të metodave tradicionale me ato bashkëkohore të mësimdhënies, duke patur në qendër herë studentin e herë pedagogun, si dhe konkretizohen me mjete audiovizuale, gjë që është shprehur edhe në syllabuset e lëndëve. [evidenca nr. 19-Silabuse shqip]</p> <p>Me Vendim Senati nr.9 datë 06.07.2023, Universiteti ka miratuar “Politikën e të nxënit, mësimdhënies dhe vlerësimit me në qendër studentin”, në mbështetje të standardeve europiane mbi cilësinë në mësimdhënie në IAL, sipas të cilës pedagogët duhet të marrin</p>

	<p>në konsideratë eksperiencat, perspektivat, nevojat, kërkesat dhe kapacitetet e çdo studenti. [evidencat 3.5-Dokumenti SCL Teaching and Assessment Policy dhe 3.6-Vendimi nr.9, datë 06.07.2023, "Për miratimin e Dokumentit SCL Teaching and Assessment Policy" ]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në dokumentin F.VII. "Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë" evidentohen forma të ndryshme me të cilat institucioni vlerëson format e mësimdhënies, veçanërisht duke përfshirë studentët në këtë proces. [evidenca nr.8]</p> <p>Format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sondazheve të studentëve dhe përmirësohen duke u bazuar në rezultatet e këtyre sondazheve. [evidenca 30.1-Shembull vlerësimi on-line nga studentët]</li> <li>- intervistave me focus-grupet e studentëve. [evidencat 30.14-shembull njoftime dhe komunikime për zhvillimin e focus-grupeve, 30.15-shpërndarja e raportit dhe ekstrakti i raportit i focus grupeve]</li> <li>- monitorimit nëpërmjet funksionimit të KSBC. [evidencat 30.5-Metodologjia e punës së KSBC-provimet, 30.11-shembull komunikimet dhe shpërndarja e raportit për provimet, 30.12-shembull-relacion për monitorimin e syllabyseve]</li> <li>- vlerësimin nga drejtuesit e njësive kryesore/bazë dhe grupeve. [evidenca nr. 30.16-G-III-4-1formulari i vlerësimin të pedagogut nga eprori-kolegu]</li> <li>- vetëvlerësimin [evidenca 41.1-shembull i formularit të vetvlerësimin të performancës i plotësuar]</li> <li>- vlerësimin nga të dhënat e Zyrës së Burimeve Njerëzore. [evidenca nr. 11-Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore]</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është një njësi autonome, e përhershme, e ngritur në nivel institucional. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe propozon ndryshime për përmirësimin të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kjo strukturë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë duke bashkërenduar aktivitetet e parashikuara në planin e saj të veprimin, në funksion të monitorimit dhe përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</li> </ul>

<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p><i>[evidencat nr.8-Dokumenti F.VII mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, 30.1- Shembull vlerësimi on-line nga studentët, 30.2-Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 30.5-Metodologjia e punës së KSBC provimet, 30.6-Format raporti për kontrollin e provimeve, 30.9-Metodologjia e punës së KSBC-silabuset, 30.11-shembull komunikimet dhe shpërndarja e raportit për provimet, 30.12-shembull-relacion për monitorimin e syllabyseve, 30.13-Metodologjia e punës së KSBC-fokus grup]</i></p> <p>Të gjitha evidencat e mësipërme japin shembuj të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka marrë të gjitha masat për të garantuar procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat e praktikat më të mira, me në qëndër studentin e që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p> <p><i>Është e domosdoshme të rekrutohet staf me formim infermieror me grada e tituj për udhëheqjen e lëndëve me karakter infermieror.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në Rregulloren e UET, kreu V “Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijes”, përcaktohen qartë mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nëpërmjet neneve: neni 23-sistemi i vlerësimit, neni 24-mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, neni 25-frekuentimi i procesit mësimor, neni 26-detyra praktike dhe detyrat e kursit, neni 27-provimet, neni 28-riprovimet dhe bartja, neni 29-kalimi në vitin pasardhës, neni 30-përmirësimet, neni 31- numri i provimeve në të njëjtin sezon, neni 32-kërkesa për rivlerësim dhe neni 33-plagjiatura dhe kopjimi. <i>[evidenca nr. 5-Rregullore UET]</i></p> <p>Gjithashtu në nenin 5 të Rregullores së programit të studimit Msc në “Infermieri”, verifikimi i dijeve të fituara nga studentët, nenin 6-frekuentimi, nenin 7-praktika profesionale dhe nenin 8-diplomimi, janë të përcaktuara qartë mënyra e testimit dhe</p>

	<p>vlerësimit të njohurive. [evidenca nr. 7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</p> <p>Studentët njihen me rregullat e mësipërme gjatë javës së orientimit, nëpër orët e mësimi nga pedagogët përkatës por edhe nëpërmjet këshillimit të vazhdueshëm nga koordinatori dhe departamenti dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. [takimi me studentët]</p> <p><b>Por do ishte mirë që rregullorja të shfaqet edhe në website të institucionit.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo lënde studentët informohen nga pedagogu i lëndës për gjithë përmbajtjen e syllabus-it të lëndës ku përveç emërimit, krediteve, titullarit, përmbajtjes së lëndës sipas veprimtarive, është e shprehur qartë edhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. [evidencat 19-silabuse shqip, 19.1-formati i silabusit]</p> <p>Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me e-mail nga koordinatori dhe departamenti. [takimi me studentët dhe stafin]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet në mënyra të ndryshme në varësi të tipologjisë së lëndës:</p> <p>Për lëndët e tipologjisë I (që janë më tepër të natyrës praktike), studenti testohet nëpërmjet dy detyrave praktike që zënë nga 30% të vlerësimit secila dhe me provimin final që zë 40%.</p> <p>Për lëndët e tipologjisë II (që janë më tepër të natyrës teorike), studenti testohet nëpërmjet nivelit të diskutimit në seminare që zë 10% të vlerësimit, detyrave të kursit 20%, provimit të ndërmjetëm (30%) dhe provimit përfundimtar 40%. Secila prej këtyre mënyrave është e paraqitur në syllabus-in e lëndës. [evidencat nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri dhe 19.1-Format silabusi]</p> <p>Këto mënyra i sigurojnë mundësinë studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre në forma të ndryshme duke konkluduar në një vlerësim final sa më objektiv të studentit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UET i ka të detajuara në Rregulloren e Institucionit, në Rregulloren e programit të studimit dhe në dokumente të tjera të posaçme procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p> <p><b>Rregullorja duhet të publikohet edhe në website të Institucionit.</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi i studentëve dhe vlerësimi i njohurive të tyre dhe i aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Kjo gjë është parashikuar në Rregulloren e UET dhe në Rregulloren e programit të studimit. [evidencat nr.5-Rregullore UET dhe 7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</p> <p>Referuar këtyre rregulloreve lëndët e tipologjisë I testohen gjatë semestrit nëpërmjet detyrave praktike të cilat vlerësohen me nga 30% të pikëve totale dhe këto pikë i mbledhen 40%-it të provimit final për të arritur në vlerësimin përfundimtar. Lëndët e tipologjisë II testohen gjatë semestrit nëpërmjet diskutimeve në seminare duke zënë 10% të vlerësimit, detyrave të kursit që zënë 20% dhe provimit të ndërmjetëm që zhvillohet në javën e shtatë të semestrit dhe zë 30% të vlerësimit total. Të gjitha pikët e marra në këtë vlerësim të vazhduar i mbledhen provimit final që zë 40% të vlerësimit.</p> <p>Të gjitha këto janë të detajuara në syllabuset e lëndëve. [evidencat nr. 19-Silabuse shqip, 19.1-format silabusi]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Përveç mënyrës tradicionale të vlerësimit UET në bashkëpunim me AADF (Albanian American Development Foundation) aplikon për lëndë të ndryshme një sistem vlerësimi elektronik "Clean-Scoring".</p> <p>Gjatë vlerësimit të vazhduar transparenca sigurohet nëpërmjet vlerësimit të diskutimeve në seminare në prani të grupit, apo referimit të detyrave të kursit apo punëve praktike përsëri në prezencë të grupit.</p> <p>Institucioni përdor programin Turnitin/Ephorous për të evituar plagjiaturën në temat e diplomës. [Takimi me drejtuesit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës zë 40% të vlerësimit në lëndët e të dy tipologjive dhe bëhet në përputhje me syllabusin e lëndës dhe rregullat e detajuara në Rregulloren e UET dhe të programit</p>

	<p>të studimit. [evidencat 5-Rregullore UET, 7-Rregullore e programit MSH Infermieri, 19-silabuse shqip]</p> <p>Hartimi i testit përfundimtar bëhet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i grup-lëndëve. Vlerësimi kryhet nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Provimet zhvillohen si rregull me shkrim dhe me procedurë sekretimi, ku sekretimi kryhet nga koordinatoja e programit në klasën ku kryhet provimi dhe kur pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në sekretarinë mësimore, sekretarja e programit të studimit ç'sekreton provimet dhe zbardh rezultatet. [evidenca nr. 9-Dokumenti E.I. mbi funksionimin e sekretarisë mësimore]</p> <p>Çdo provim monitorohet nga më shumë se një pedagog sipas grafikut të miratuar nga drejtuesi i departamentit.</p> <p>Rregullorja e UET dhe ajo e programit të studimit e ka të përcaktuar qartë procedurën e ankimimit të vlerësimit nga studentët, por nuk kishte asnjë rast konkret ankimimi. [evidencat 5-Rregullore UET dhe 7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në Rregulloren e UET neni 27 thuhet se vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve. [evidenca nr. 5-Rregullore UET]</p> <p>Gjithashtu në dokumentin A. IV. "Sistemi i vlerësimit të studentëve", pika 1.2 thuhet se vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe jo penalizuese. Ai synon të tregojë se çfarë di studentin dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë qëllim çdo vlerësim i pedagogut duhet të shoqërohet me shpjegimin përkatës. [evidenca nr. 7.2- dokumenti A. IV. "Sistemi i vlerësimit të studentëve] [kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentët].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni 33 pikat 1,2,3 në Rregulloren e UET e ka të përcaktuar shumë qartë moslejin si të kopjimit në provim ashtu edhe të plagjiaturës në detyra. Gjithashtu ka të shprehura edhe masat që merren në raste të tilla. [evidenca nr.5-Rregullore UET]</p> <p>Pedagogët që monitorojnë gjatë provimit, kujdesen për zbatimin e këtij rregulli dhe gjithashtu verifikimi nëpërmjet sistemit Turnitin/Ephorous nuk lejon plagjiaturën në detyra kursi apo projekte.</p> <p>Nuk kishte raste konkrete me problematika të kësaj natyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas</p>	<p>Sipas nenit 27 të Rregullores së UET, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimin e studentit deri në korigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.</p>

<p>përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve.</p> <p>Dorëzimi i vlerësimit të provimeve bëhet brenda dy javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese. <i>[evidenca nr.5-Rregullore UET]</i></p> <p>Zbatimi i këtij neni të Rregullores bën që rezultatet e studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar. <i>[takimi me studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Procedura e ndjekur për vlerësimin e studentit është transparente, e dokumentuar dhe e arkivuar.</p> <p>Studenti informohet në kohë reale për vlerësimin nëpërmjet sistemit LMS dhe informohet nga koordinatojta e departamentit për orarin që pedagogu ka vendosur për seancat sqaruese.</p> <p>Gjatë këtyre seancave studenti ka mundësi të rishikojë tezën dhe pedagogu e informon në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe gabimet që ka bërë.</p> <p>Neni 32 i Rregullores UET e ka të detajuar si procesohet kërkesa e studentit për rivlerësim. <i>[evidenca nr.5-Rregullore UET], [takimi me studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Përveç nenit 32 të Rregullores së UET, mënyra se si trajtohen ankimimet e studentëve për vlerësimin është e shprehur shumë qartë në nenin 5.8 të Rregullores së programit të studimit i cili thotë:</p> <p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim Drejtuesit të Departamentit, ku të parashtrojë arsyet ku e bazon ankesën.</p> <p>Me marrjen e ankesës Drejtuesi i Departamentit ose Dekani ngre një komision me tre pedagogë për shqyrtimin e ankesës dhe rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i></p> <p>Procesverbalet e vlerësimit firmosen, dorëzohen në sekretarinë mësimore dhe arkivohen në zyrën e sekretarit të përgjithshëm.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka të detajuar në Rregulloren e vet dhe në të gjitha aktet e tjera rregullatore gjithë procedurat që sigurojnë një vlerësim të drejtë dhe transparent duke u bazuar në meritën e çdo studenti.</i></p>

	Gjithashtu një vend të posaçëm zë edhe procedura e ankimimit të vlerësimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Referuar kurrikulës së programit të studimit Msc në “Infermieri”, vihet re që disiplinat që e përbëjnë synojnë të thellojnë aftësitë profesionale infermiore të marra në studimet <i>bachelor</i> , duke zhvilluar jo vetëm aspektin teorik e të kërkimit shkencor por edhe aftësimin praktik profesional. [evidenca nr. 14-Kurrikula e programit MSH Infermieri] Impakti që kishte ndjekja e këtij programi në aftësimin e profesionistit të së ardhmes u vu re edhe në takimin me studentët që shpreheshin të sigurt për kalimin në tregun e punës mbas diplomimit. [ takimi me studentët]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar përsëri kurrikulës së programit të studimit, vihet re se një vëmendje e veçantë i kushtohet formimit human, psikologjik e social me lëndë të tilla si psikologji shëndeti apo psikopatologji, por edhe komunikimit, ndërveprimit, menaxhimit e formimit të lidërshiptit, me lëndë të tilla si Komunikimi, Etika dhe Lidërshipi në Organizatë apo Menaxhimi Shëndetësor dhe Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore. Por nuk ka asnjë modul që lidhet me aftësimin në fushën e teknologjisë së Informacionit që është edhe prirja e së ardhmes në të gjitha profesionet, përfshirë edhe fushën e shëndetit. [evidenca nr.14-Kurrikula e programit MSH Infermieri] Sipas Rregullores dhe Planit Strategjik një pjesë e lëndëve mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë	Nga takimi me stafin dhe studentët u konfirmua [evidencat nr. 3-Plani Strategjik UET 2021-2025, 5-Rregullore UET, 19.1-format silabusit] se në përmbyllje të semestrit, në orët e fundit të seminareve, verifikohet përmbushja e objektivave të programit të lëndës në përfitim të kompetencave dhe aftësive të studentit dhe shoqërohet edhe me vlerësimin përkatës (10%), të paraqitura në syllabus-in e lëndës. Gjithashtu përfitimi i këtyre aftësive




<p>në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>verifikohet edhe nëpërmjet realizimit dhe interpretimit të detyrave të kursit që kanë objektiva të qarta si për nga ana e përfitimit të aftësive praktike, por edhe në drejtim të një minikërkimi shkencor. Gjithashtu pedagogu orienton studentët lidhur me çështjet më të rëndësishme që do të përfshihen edhe në detyrimet përmbyllëse të lëndës. <i>[takimi me studentët dhe stafin]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Si një program i ciklit të dytë të studimeve që ka për qëllim thellimin e njohurive dhe kompetencave të marra në ciklin e parë, i kushtohet vëmendje e veçantë dhe kohë specifike e mjaftueshme, dërgimit të studentëve në qendra spitalore dhe ndjekjes së tyre nga profesionistët përkatës të angazhuar si pedagogë për të ushtruar konkretisht çdo procedurë që parashikohet në programin e praktikës. Në rastet e ndryshme klinike nxitet diskutimi dhe interpretimi i rastit duke demonstruar mendim kritik dhe aftësi vendimmarrëse në situata komplekse klinike. <i>[evidencat nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri, 19-silabuse shqip, 32.1-Dokumenti B.I. mbi praktiken profesionale]</i></p> <p>Gjithashtu në këtë program studimi puna në grup zë një vend të veçantë. Ky kriter është theksuar edhe në syllabus dhe në format e vlerësimit të lëndëve. <i>[evidenca nr. 19-silabuse shqip]</i></p> <p>Siç u tha dhe në kriterin më sipër dhe është e parashikuar edhe në syllabus, studentët realizojnë detyra kursi në grup ku secili bën pjesën e vet në funksion të realizimit të një objektivi të caktuar mësimor. Kjo evidentohet edhe në objektivat e programit të studimit të shprehur në Rregulloren e këtij programi. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i></p> <p>Mobilitetet në kuadër të projekteve Erasmus+ KA1 mundësojnë rritjen e shkëmbimit të experiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të universiteteve europiane. <i>[evidencat nr. 28.1.1-Rregullore per shkëmbimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta., 28.2-Inter institutional Agreement UET].</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik miratohet kalendari i aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë vitit duke u dhënë mundësinë studentëve të njihen me profesionistë të ndryshëm të fushës së shëndetit. Staf i akademik bashkëpunon dhe ndërmjetëson për të sjellë këta profesionistë, të cilët në bashkëpunim me stafin efektiv zhvillojnë leksione të hapura dhe seminare të ndryshme. Këto aktivitete janë shumë të vlefshme për ngritjen profesionale të studentëve sepse u japin atyre mundësi të përfitojnë njohuri të reja dhe të marrin informacione të vlefshme për pyetjet e ndryshme që mund të kenë. <i>[evidenca nr.33-Të dhëna për trajnimet profesionale staf-student]</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Pika 3.4 e Strategjisë së Kërkimit Shkencor UET citon: nëpërmjet kërkimit shkencor UET synon të realizojë një mjedis stimulues të kërkimit shkencor për stafin dhe studentët. [evidenca nr. 3.1-Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025]</p> <p>Gjithashtu edhe Plani Strategjik i ka shumë të qarta mënyrat e përfshirjes dhe nxitjes së studentëve në kërkimin shkencor të mbështetur financiarisht. [evidenca 3-Plani strategjik UET 2021-2025]</p> <p><i>Por nuk ka asnjë evidencë të realizimit të këtij kriteri.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ndërtimi i programit të studimit Msc në “Infermieri”, Kurrikula e tij, Strategjia, Rregullorja dhe zbatimi rigoroz i këtyre dokumenteve, garantojnë rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore të tyre.</i></p> <p><i>Nevojitet një nxitje e pjesëmarrjes së studentëve në programe ndërkombëtare mobiliteti dhe në projekte me financim.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar ne ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, detyrimet përmbyllëse të programit MSH në “Infermieri” realizohen me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome. Në Rregulloren e këtij programi, neni 8 i saj, janë të detajuara gjithë hallkat e procedurës së diplomimit të studentëve. Studentët janë të mirinformuar lidhur me këtë procedurë dhe zgjedhja e temës dhe puna për të, nis që në fillim të vitit të dytë. [evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në pikën 8.2 të Rregullores së programit të studimit bëhet e ditur se në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh të shpallur dhe studenti është i detyruar t'i frekuentojë ato në masën 60%. [evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri] Gjatë këtyre seancave pedagogët udhëheqës i asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione,</p>




	<p>udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të realizimit me sukses të temës.</p> <p>Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë. <i>[evidenca nr. 10-Dokumenti B.II mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</i></p> <p>Por gjatë takimit në institucion u evidentua një vështirësi konkrete në udhëheqjen e studentëve për punimin e diplomës për shkak të numrit shumë të madh të studentëve të regjistruar dhe numrit të vogël të stafit që mund të angazhohet në udhëheqje si dhe mundësive konkrete të propozimeve për tema të ndryshme diplome nga ana e tyre, në përmbushje të pikës B.II.2.2. të dokumentit B.II-Mbi punimin e diplomës/disertacionit. <i>[takimet në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet pasi sipas nenit 75/5 të ligjit 80/2015, studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përmbillen me punim diplome.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Dokumenti B.II “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”, ka të specifikuar në mënyrë të qartë gjithçka duhet, lidhur me punimin e diplomës, duke i ardhur në ndihmë studentit dhe pedagogut udhëheqës. Sipas këtij dokumenti pasi është bërë zgjedhja e temës së diplomës nga fondi i temave të vendosura në dispozicion të departamentit nga pedagogët sipas ekspertizave të tyre, pedagogët udhëheqës të diplomës zhvillojnë seanca metodologjike për studentët, sipas një kalendari takimesh të shpallur. Gjatë këtyre seancave, pedagogu e asiston studentin në gjithçka ka të bëjë me punimin e diplomës, që nga zgjedhja e temës deri në miratimin final për t’u paraqitur para komisionit, të specifikuar me detaje në pikat B.II.5.1,2,3,4 të dokumentit të cituar më sipër. <i>[evidenca nr. 10- Dokumenti B.II “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”]</i></p> <p>Ky dokument gjithashtu i jep informacion studentit për strukturën e prezantimit të një teme diplome.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Sipas dokumentit B.II. , UET i asiston gjatë gjithë kohës studentët me ekspertizë të ofruar si nga pedagogët udhëheqës për ndërtimin e instrumentave matës (p.sh. pyetësorët), për kryerjen e matjeve apo testimet brenda dhe jashtë institucionit, por edhe nga stafi ndihmës i UET për realizimin e nxjerrjes së rezultateve apo</p>

jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	përpunimit të tyre. [evidenca nr. 10- Dokumenti B.II “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”]
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Dokumenti B.II. specifikon gjithashtu në mënyrë të hollësishme edhe procedurën dhe kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës. [evidenca nr. 10-Dokumenti B.II “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”]. Midis të tjerash në këtë kapitull të këtij dokumenti citohet që punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet e UET-it dhe ka përmbyshur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda gjashtë muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me çertifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës në gjuhët shqip dhe anglisht, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Rregullore UET neni 40 [evidenca nr. 5-Rregullore UET]. Çdo diplomë përpara se të lëshohet nga UET-i, rregjistrohet sipas legjislacionit në fuqi. dokumenti B.II.15.3 [evidenca nr. 10-Dokumenti B.II “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”] Sekretarja e programit të studimit, sipas dokumentit E.I.5.4., plotëson suplementin e diplomës, sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për arsimin. [evidenca nr.9-Dokumenti E.I. mbi funksionimin e sekretarisë mësimore] Studentit i jepet kopje e plotë zyrtare e programit të studimit vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë, kundrejt një pagese. [takimi me drejtuesit]
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit, Agjensisë për Sigurimin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, apo nevojave të vet institucionit. Zyra e kontratave dhe sekretaria në bazë të rregullores së arkivë protokollit dhe afateve të përcaktuara në të, ruajnë dhe arkivojnë dokumentacionin sipas kriterit. [vizita në sekretarinë mësimore]
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton një procedurë të detajuar shumë qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në këtë program studimi, konform legjislacionit në fuqi. Gjithçka realizohet sipas dokumentacionit të nevojshëm dhe studentit i vendoset në dispozicion diploma, lista e notave dhe suplementi i diplomës, sipas përcaktimeve të Ministrisë së Arsimit.</i>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Kriteri nuk aplikohet.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Kriteri nuk aplikohet.
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Kriteri nuk aplikohet.
<b>Konkluzione</b>	<i>Standardi III/6 nuk aplikohet në këtë program, pasi është Master Shkencor dhe jo Profesional.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem, GVJ konstatoi se Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Institucioni ka hartuar rregullore specifike për modalitetin e rekrutimeve të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Paralelisht, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore gjendet dosja e secilit nga anëtarët e departamentit ku përfshihet dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu CV-në e pedagogëve si dhe diplomat e fituara. Sipas takimeve në terren, personeli akademik mbulon në rastet më të shumta lëndë/module në bazë të studimeve si dhe të fushës kërkimore. Stafii akademik PAE/PAK i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike, është si më poshtë:						
	<b>Kualifikimi i stafit akademik të PS</b>	<b>2022-2023</b>		<b>2023-2024</b>		<b>2024-2025</b>	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	1	-	1	-	1	-
	Prof. Asoc.	2	-	2	-	3	-
Dr/Phd	4	1	4	2	4	1	

	Msc.	-	1	1	3	1	3
	Gjithsej	7	2	8	5	9	4
	<p><i>Aneks tabelat permbledhese, tabelat 6.1, 6.2, 6.3.</i>  <i>[tabela 1.1], [tabela 6.2]</i>  <i>[evidenca 23] [evidenca 31.4], [evidenca 44.1], [evidenca 44.2]</i></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve në terren, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit Msc në “Infermieri”, mbulon ngarkesën mësimore, ku cdo pedagog mbulon 60 orë mësimore, sipas detyrimeve ligjore, në lidhje me Stafin akademik me tituj, por theksojmë që Universiteti duhet të synojë të ketë staf të profilit dhe kjo është domosdoshmëri.  <i>[evidenca nr. 02] tabelave 12.2, 12.3, 12.4 te aneks tabelat permbledhese.</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Universiteti ka depozituar pranë ASCAL dokumentacion i cili konfirmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të këtij programi studimesh për periudhën e akreditimit. Dokumentacioni përfshin informacion mbi kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe suplementare konform kuadrit ligjor në fuqi. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm pasi për zgjidhen me konkurs në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit, firmosin kontratë pune konform rregullave të punësimit të Universitetit European të Tiranës. <i>[Takimi me drejtuesit]</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi bazuar në kriteret të përgjithshme dhe specifike. Pas takimit me Drejtuesen e Departamentit të Msc në “Infermieri”, morëm si përgjigje se UET ka miratuar rregullore specifike të modaliteteve për rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ. Shpalljet për rekrutim bëhen publike ndërsa aplikuesit njoftohen mbi pikëzimin në bazë të kriterëve të përcaktuara. Institucioni ndjek një procedurë standarte ku Departamenti përkatës vendos kriteret specifike për rekrutim në bazë të nevojave të programit dhe moduleve që do të trajtojnë. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe më pas dekanati i përcjell në Rektorat. Pas shpalljes, Rektori ngrë një Komision vlerësimi të cilët janë anëtarë të Njësisë Kryesore ndërsa një përfaqësues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është prezent si vëzhgues i procedurës dhe pa të drejtë vote. Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka në dispozicion të</p>						

	<p>gjithë informacionin nga shpallja deri në firmosjen e kontratës. Në statutin e UET përcaktohen qartë po ashtu procedurat e punësimit.</p> <p><i>[Takimi me drejtuesit]</i></p> <p><i>[evidencë 2]; [evidencë 23]; [evidencë 24]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nuk ka në dispozicion personel ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike si dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe të mjediseve të tjera mësimore. Orët laboratorike zhvillohen nga personel i cili është në përputhje me nevojat e programit të studimit. <i>[evidencat nr. 19-Silabuse shqip, 20-CV e stafit akademik të programit të studimit, 24-Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite]. [Në takimin me Dekanen dhe Drejtuesen e Departamentit, kjo mangësi u argumentua me mungesën e stafit infermieror me tituj e grada shkencore]</i></p> <p><i>GVJ mendon se kjo nuk përmbush nevojat e fakultetit, pasi nuk përputhet me numrin e studentëve. GVJ mendon, se fakultetit duhet të shohjë numrin e stafit ndihmës.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar. Në takimin që zhvilloi GVJ u informua se Drejtoria e Burimeve Njerëzore informon Institucionin, në lidhje me personelin. Secili ka akses vetëm në informacionin e nevojshëm në bazë të statusit të tij (sekretare, pedagog, drejtues Njësie Bazë, Drejtues Njësie Kryesore). Pedagogët kanë të gjithë akses në system, ku përfshihen lëndët/modulet të cilat ata zhvillojnë nga Drejtuesi i Departamentit. Në takimin që u bë, u informua se secili anëtar i stafit akademik ka dosje individuale të krijuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore që mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit harton dhe shpërndan ngarkesën mësimore të secilit anëtar të personelit akademik që janë pjesë e departamentit që drejton, Çdo anëtar i stafit akademik përditëson dosjen duke raportuar zhvillimet mbi kërkimin shkencor që merr përsipër, projektet e realizuara gjatë vitit akademik, pjesëmarrjen në konferencat shkencore. <i>[evidenca nr. 23-të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>Personeli i angazhuar në realizimin e praktikave mësimore profesionale shoqeron studentët në qendrat ku ata zhvillojnë praktika. Gjithashtu në takimin që u bë me pedagogët, u informua se në klinika studentët asistohen nga mbikqyrësit e studentëve, profesionistë që punojnë në klinika. Mbikqyrësi që asiston studentët në zhvillimin e praktikës gjithashtu merr pjesë në</p>

<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>vlerësimin e tyre sipas rasteve. Në takimet e zhvilluara nga GVJ, stafi akademik raportoi se studentët ndiqen në mënyrë të rregullt gjatë zhvillimit të praktikës (zakonisht nga staf si Asistent Pedagogë) dhe kjo u konfirmua edhe nga studentët. Por vëmë re që stafi përbëhet vetëm nga 2 pedagogë të profilit, numër ky i pamjaftueshëm. [evidencat nr. 14.2-Plani mësimor i programit, evidenca nr. 32.2-Formularët e praktikave, evidenca nr. 32.4-Dosje studenti praktike profesionale, evidenca nr. 32.5-Dosje studenti praktike ndërlëndore]. [përkatësisht evidenca 32.4-dosje studenti praktike profesionale dhe evidena nr. 32.5-dosje studenti praktike ndërlëndore], [takimi me stafin]</p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në takimin me përgjegjësin e Departamentit, bëhemi me dije se ata kanë referente pritës në spitalet përkatëse ku shkojnë studentët, për realizimin e praktikave. Pedagogët që angazhohen me mbarevajtjen e praktikës, ngelen po vetëm 2 pedagogë të profilit. [evidenca nr. 32.1-dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale] [Vizita në Institucion, takimi me studentët].</p> <p>GVJ vlerëson se është domosdoshmëri që ata që përgatisin studentë të infermierisë të jenë domosdoshmërisht të profilit dhe numri i tyre në Universitetin e UET ngelet i vogël.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe ka hartuar rregullore specifike për modalitetin e rekrutimeve të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Personel ndihmës akademik nuk angazhohet në programin e studimit, por theksojmë që duhet të angazhohet [Vizita në institucion]. Në marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera janë në implementim. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht. [evidenca nr.34 Marrëveshje bashkëpunimi]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin me qëllim kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike disponon, si dhe u evidentua nga vizita në terren, GVJ konstatoi se FSHMT ka ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p>UET disponon një sërë laboratorësh të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Përveç kapaciteteve të brendshme laboratorike, UET ka lidhur kontrata qiraje me palë të treta, për zhvillimin e orëve laboratorike, sipas planit përkatës mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore, duke instaluar programet aplikative, që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështetin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS). <i>[evidenca nr. 46,1 Mbi punën e platformave LMS]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në vizitën që bëri GVJ, konstatoi që institucioni është i pajisur me laboratorë mësimorë 11.543 m<sup>2</sup> (190 vende). Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.</p> <p>Sallat dhe laboratorët garantojnë realizimin e procesit teorik dhe atë laboratorik.</p> <p><i>[vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave</p>	<p>Infrastruktura akademike në funksion të programit, Universiteti European i Tiranës përfshin Godinën C ku janë laboratorët e arteve, me sipërfaqe 444.8 m<sup>2</sup>. Gjithashtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik. Në vizitën që bëri GVJ, na raportuan se ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëëbin. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Pajisjet dhe programet</p>




formues të programit të studimit në tërësi.	e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. <i>[evidencë 42], [vizita në institucion]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës së zhvilluar në mjediset mësimore, klasat ishin të pajisura me mjete elektronike si video-projektor e perde për zhvillimin e mësimdhënies me përdorimin e mjeteve teknologjike të reja. Pedagogët përdornin zakonisht laptop-in e vet për implementimin e mësimdhënies. Laboratorët ishin të pajisur dhe me mjete të natyrës së programit të studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe vizitës në terren, Institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi. Paralelisht, Institucioni ka marrëveshje me struktura për realizimin e programit të studimeve. Po ashtu, Institucioni zhvillon praktikat mësimore edhe në ambientet ambulatorë përfshirë këtu, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni", <i>por theksojmë që Universiteti nuk ka rinovuar kontratat me spitale të tjera Universitare.</i> <i>[evidenca nr.34 Marrëveshje bashkëpunimi]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se Institucioni ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin me qëllim kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor. Institucioni ka në dispozicion për implementimin e këtij programi studimi disa laboratorë përfshirë këtu Laboratorin e Informatikës, Laboratorin e Infermierisë etj. Paralelisht, Institucioni ka marrëveshje me struktura spitalore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.3**

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve literaturë digjitale. Pjesë e vogël e literaturës fizike gjendet në librarinë e Fakultetit si dhe atë qendrore të Institucionit ndërsa aksesit në library on-line është i mundur. Biblioteka e UET disponon literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Ekziston salla e bibliotekës 40 m<sup>2</sup> dhe salla e leximit 50 m<sup>2</sup> me 41 vende leximi. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online Sage&amp;EBSCO, në të cilat është abonuar institucioni. Institucioni deklaron se pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>[evidenca nr. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke].</i></p> <p><i>[vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas takimit me pedagogët, ata përditësojnë literaturën e përdorur duke përdorur botime të viteve të fundit.</p> <p>Njësia përgjegjëse komunikon me Përgjegjës të Bibliotekës për përditësimin dhe pasurimin e fondit të Bibliotekës me literaturë e nevojshme, për një zhvillim normal të procesit mësimor dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore në UET. Numri i kopjeve të çdo materiali të ri, që hyn në Bibliotekë, nga Departamenti duke marrë për bazë llojin e botimit dhe nevojat për të, si edhe kërkesat e studentëve. <i>[evidenca nr. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke].</i></p> <p><i>[vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve sallën e bibliotekës 40 m<sup>2</sup> dhe sallën e leximit 50 m<sup>2</sup> me 41 vende leximi. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online në të cilat është abonuar institucioni. Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit. Publikime të ndryshme të cilat ishin në dispozicion të studentëve.</p>




	<p><i>[evidenca nr. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke].</i></p> <p><i>[vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka, si ajo qëndrorja edhe e Njësisë Kryesore ishte e pajisur me tekste mësimore, literaturë ndihmëse si dhe publikime (<i>sidomos të Buletinit të UET edhe/ose aktiviteteve shkencore të organizuara</i>) të cilat mbulonin pjesë të moduleve të programit të studimit. Në fondin e saj duhet të gjenden domosdoshmërisht tekstet bazë/literatura bazë për çdo program studimi, sipas listës së përpiluar nga departamentet. Në bashkëpunim me Drejtuesit e Departamenteve, Biblioteka harton listën e pasurimit të vazhdueshëm të fondit të saj, para fillimit të çdo viti akademik dhe ia kalon atë Administratorit për miratimin e blerjes së tyre.</p> <p>Çdo student dhe pedagog ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha librat, broshurat, revistat, gazetat dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj, të cilat gjenden dhe ruhen në Bibliotekë.</p> <p><i>[evidencë 2.2]</i> Çdo student, pedagog ose punonjës i UET-it kur regjistrohet në Bibliotekë njihet me rregullat e përdorimit të literaturës që zotërohen prej saj.</p> <p>Materialet që shërbehen jashtë Bibliotekës u jepen anëtarëve të saj për një periudhë kohe jo më shumë se 1 javë. Për vonesat ose për humbjet e këtyre materialeve kërkohet zëvendësimi i tyre me po të njëjtin titull dhe vit botimi, ose zhdëmtimi financiar sipas.</p> <p><i>[evidencë 45.2], [evidencë 45,1], [evidenca nr. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke].</i></p> <p><i>[vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni u jep mundësinë studentëve të kenë akses në biblioteka on-line dhe pa kosto. Studentët kanë mundësinë të aksesojnë u-library e cila është vënë në dispozicion nga MAS ndërsa vet Institucioni përmes projektit CleanScore ka përfituar akses falas për të gjithë studentët në librarinë JSTORE. Në takimin me studentët ata raportuan njohje të këtyre mundësive për të aksesuar biblioteka on-line.</p> <p><i>Theksojmë që literaturë bazë është e huaj dhe kjo nuk përkon me ligjin në fuqi. [evidenca nr. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke].</i></p> <p><i>[vizita në institucion], [evidencë 45.2], [evidencë 45,1]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Bibliotekat, sipas vizitave të zhvilluara në terren, ishin të pajisura me kompjutera në të cilat studentët kishin mundësi ti përdornin pa kufizim. Sipas takimit të zhvilluar, studentët kishin mundësi të</p>

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	aksesonin edhe bibliotekat on-line përmes kompjuterave të disponueshëm nga të cilës shkarkonin literaturën e nevojshme.  <i>Vizita në Institucion</i>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Bibliotekat ishin në dispozicion të studentëve gjatë procesit mësimor si dhe përtej atij. Biblioteka e Njesisë Kryesore ishte në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premten nga ora 08:00 deri në orën 16:00 ndërsa ajo qëndrorja nga ora 08:00-19:00 gjatë javës dhe 08:00-16:00 të shtunën. Oraret ishin të afishuara dhe jashtë bibliotekës.  <i>[Vizita në Institucion]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nuk u vu në dispozicion të GVJ informacion specifik mbi ndjekjen dhe raportimit e cilësisë së fondit fizik dhe atij on-line të bibliotekës. Të dhëna mbi fondin fizik të bibliotekës janë dorëzuar pranë ASCAL ndërsa informacion mbi shfrytëzimin e këtij fondi nga personeli akademik dhe studentët gjendet në raportin vjetor të institucionit por në nivele të pakta. Vitet e fundit fondi i bibliotekës është pasuruar sipas evidencave buxhetore. <i>Nuk u dha informacion specifik mbi pasurimin e fondit të bibliotekës për këtë program studimi.</i>  <i>[Vizita në Institucion]</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se Institucioni ka në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve literature fizike dhe digjitale. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën e Institucionit si dhe bibliotekën pranë Njesisë Kryesore. Pjesë e literaturës fizike nuk është e mjaftueshme që gjendet në librarinë e Fakultetit si dhe atë qëndrore të Institucionit ndërsa aksesimi në library on-line është i mundur. Bibliotekat ishin në dispozicion të studentëve gjatë</i>

	<i>procesit mësimor si dhe përtej atij. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Një sistem i menaxhimit është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Në takimin me studentët, konfirmojnë që cdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Sistemi nëpërmjet të cilit UET administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është sistemi UMIS. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin automatik me anë të email-it ose me mesazhe për aktivitete të ndryshme, regjistrimi në kurse apo programe të ndryshme. <i>[evidenca nr. 46. Manuali i perdoruesve te sistemit UMIS]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Drejtoria e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e informacionit mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ajo infomon sektorin e IT-së mbi të gjitha nevojat/ndryshimet dhe ai realizon përditësimin e nevojshëm. Drejtoria e burimeve njerëzore krijon, shikon, përditëson dhe gjeneron të dhëna lidhur me personelin akademik, ndihmësakademik, administrative, strukturën organizative, si dhe gjeneron statistika bazuar në informacionin që gjendet në UMIS. <i>[evidenca nr. 46. Manuali i perdoruesve te sistemit UMIS]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të	UMIS siguron akses të dedikuar për personelin akademik dhe studentët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në

<p>dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e UET. Drejtuesi i Departamentin ka akses të veçantë. Ai administron aksesin për pedagogët e Departamentit, administron planet mësimore me fillimin e semestrit, monitoron personelin akademik si dhe gjeneron nga sistemi të dhëna mbi Departamentin që drejton. Pedagogët kanë akses në sistem për të gjeneruar procesverbalin, për të hedhur arritjet akademike të studentëve etj. [evidenca nr. 46. Manuali i perdoruesve te sistemit UMIS.], [Vizita në institucion, takimi me pedagogët]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar theksohet që sistemi jep mundësinë për komunikim interaktiv apo/edhe për shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve e studentëve. Sipas vizitës në terren, ky sistem menaxhimi përdoret për komunikim interaktiv të pedagogëve me studentët apo për shpërndarjen e informacionit.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi UMIS garanton monitorim në kohë reale të aktiviteti akademik e administrative si dhe jep mundësinë për raportime individuale. Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Drejtuesi i Njësisë Bazë kanë mundësi të monitorojnë të dhëna që lidhen me njësinë përkatëse që ata drejtojnë. Dekani si dhe drejtuesi i departamentit monitorojnë në kohë reale mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>[vizita në institucon, takimi me stafin akademik]</i> <i>[Takim me studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacion mbi programet e studimit, personelin akademik, CV-të e tyre, organizimin e aktiviteteve të ndryshme etj, publikohen në faqen zyrtare të UET</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se sistemi i menaxhimit (UMIS) është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Drejtorja e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin</i></p>

	<i>dhe administrimin e informacionit mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Sipas vizitës në terren, ky sistem menaxhimi përdoret për komunikim interaktiv të pedagogëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni ka hartuar një raport financiar mbi koston e programeve të studimeve. Për vitin akademik 2022 -2023 kosto e përgjithshme për pagesat e Pedagogëve për gjithë Universitetin. <i>GVJ nuk ka të specifikuar një pasqyrë financiare, për Ciklin e dytë të studimit Master Shkencor.</i> Institucioni ka paraqitur një pasqyrë financiare mbi të ardhurat nga shërbimet ku përfshin: tarifat e shkollimit për diplomat Bachelor, master dhe doktoraturë në total dhe jo specifikisht për Master Shkencor. Nuk u raportua informacion për mbarëvajtjen financiare të programit Master Shkencor në "Infermieri" për të paktën një cikël të plotë studimi. [evidenca nr.50.2. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime] [evidenca nr.50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime] [evidenca nr 50.4. Raport auditimi viti 2021]

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, për të gjithë stafin e Universitetit.</p> <p>Gjithashtu jep dhe tarifat për shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grantet e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trajnuese. <i>Plani financiar zhvillohet në nivel institucioni dhe nuk është i disponueshëm plan i financimit të njësisë bazë e cila ofron programin e studimit Master shkencor në Infermieri</i></p> <p>Institucioni ka paraqitur një pasqyrë financiare në lidhje me, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare.</p> <p><i>[evidenca nr.50.2. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime]</i>  <i>[evidenca nr.50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime]</i>  <i>[evidenca nr 50.4. Raport auditimi viti 2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga struktura të brendshme e të jashtme. UET ka ngritur “Auditin e Brendshëm” në varësi të Bordit të Administrimit. Paralelisht, Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga auditimi i MAS dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditimi vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. Në dokumentat e dorëzuara në ASCAL u depozitua nga UET raport auditimi për vitin 2022-2023</p> <p><i>[evidenca nr.50.2. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime]</i>  <i>[evidenca nr.50.3. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime]</i>  <i>[evidenca nr 50.4. Raport auditimi viti 2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p><i>Njësia Bazë nuk zhvillon raportim financiar.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të</p>	<p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit. Në fund të çdo viti kalendarik institucioni harton raportin vjetor ku përfshihet dhe raportimi financiar. Nuk u</p>




<p>njesisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>depozitua informacion mbi ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve ndërsa gjatë takimeve.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka hartuar një raport financiar mbi koston e programeve të studimeve. Për vitin akademik 2022 -2023 kosto e përgjithshme jo specifikisht për Master Shkencor. Nuk u raportua informacion për mbarëvajtjen financiare të programit Master Shkencor në "Infermieri", për të paktën një cikël të plotë studimi. Plani financiar zhvillohet në nivel institucioni dhe nuk është i disponueshëm plan i financimit të njesisë bazë e cila ofron programin e studimit Msc në "Infermieri". Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve</p>	<p>UET ka hartuar Statutin, Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e FSHMT, rregulloren e programit të studimeve si dhe procedura dhe zbaton politika të ndryshme të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Në këto dokumenta të</p>

<p>nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>miratuara përcaktohen qartë procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Dokumentacioni i miratuar dhe politikat e hartuara janë në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe aktet e veta rregullatore. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i> <i>[evidenca nr. 27.1. Dokumenti DI Mbi politikat, kriteret dhe proceset e pranimit të studentëve]</i> <i>[evidenca nr. 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin (Tabela 21)].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. <i>[takimi me studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në bazë të legjislacionit në fuqi, FSHMT harton, miraton dhe publikon kriteret për pranimin në programin e studimeve Master Shkencor në "Infermieri". Kriteret e pranimit si dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik dhe i përcillen MAS dhe QSHA. <i>[evidenca nr. 27.1. Dokumenti DI Mbi politikat, kriteret dhe proceset e pranimit të studentëve]</i> <i>[evidenca nr. 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin (Tabela 21).]</i> <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit dhe syllabus-et kanë informacion të qartë e të detajuar për përparim përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve etj. Tek rregullorja e Departamentit, jepen informacione të detajuara mbi organizimin e studimeve, kontrollin e dijeve dhe vlerësimin, transferimin e studimeve, njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit ndërsa tek rregullorja e programit mësimor jepet informacion mbi procedurat e pranimit. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i> <i>[[evidenca nr.4. Plani strategjik për këtë programit të studimit të MSH]. [evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar në rregulloret e departamentit dhe të programit të studimit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të ciklin e dytë është i mundur për çdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve në fushat që lidhen me programin e studimeve, por nuk janë të specifikuar cilat diploma konkrete te ciklit të parë. Në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues ka evidencë të procedurës ligjore të ndjekur çdo vit për hartimin dhe publikimin e kriterëve për pranimin në ciklin e dytë të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programin e studimit Msc në “Infermieri”, publikohen në faqen zyrtare të Institucionit. Nota mesatare e diplomës në programin e parë (<i>Bachelor</i>) të studimit është vendosur si kriter pranimi ndërsa si kriter përzgjedhjes është mesatarja e ponderuar e aplikantëve në programin e studimit Bachelor. Politikat dhe procedurat e pranimit në këtë program studimi detajohen në rregulloren e programit të studimeve. [evidenca 6. Dokumenti F.IV-FV Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit], [evidencë 4]; [evidencë 5]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ nuk konstaton që në pranimin në këtë program studimi të jenë hartuar kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Sipas diskutimeve me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, respektohen aftësitë ndryshe të personave që aplikojnë. [Takimi me drejtuesit]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që në këtë program studimi nuk janë hartuar kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, por në takimin e realizuar me Drejtues të Departamentit, na u tha që po vijojnë me programin Erasmus, ku do të bëjnë të mundur dërgimin e studentëve në fakultetet si motra. Gjithashtu u bëmë me dije se pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe nga vende të tjera pasi kandidatët kryejnë procedurën e fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Sipas diskutimeve me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, kandidatë nga trojet janë regjistruar në këtë program studimi në të kaluarën. [Vizita në Institucion], [Takimi me drejtuesit]</p>

<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Në bazë të legjislacionit në fuqi, Institucioni miraton politika ndihmëse dhe bursa për studentët.</p> <p><i>[Vizita në Institucion], [Takimi me drejtuesit], [Takimi me studentët]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Në dokumentacionin e hartuar nga UET ekzistojnë evidenca të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje duke garantuar barazi për të gjithë studentët. Kriteret e pranimit si dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik dhe i përcillen MAS dhe QSHA ndërsa informacion i detajuar mbi procedurat e pranimit është i disponueshëm për studentët dhe publikun. Nuk ka kritere specifike për grupet me aftësi ndryshe ndërsa aksesimi për studentë të huaj është e mundur (veçanërisht për ata nga trojet). Bursa dhe përjashtime nga tarifa janë në dispozicion të studentëve në bazë të kushteve ligjore. <i>[Vizita në Institucion], [Takimi me drejtuesit], [Takimi me studentët]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Tek rregullorja e Departamentit, jepet informacion mbi kushtet e detyrueshme në kalimin në vitin pasardhës. Në syllabus-et e programit gjendet po ashtu informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik.</p> <p><i>[evidencë 5]; [evidencë 19]; [evidencë 27.1]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në takimin që realizojë me Studentët, GVJ mësoi se ata kanë akses në informacion në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme.</p> <p><i>[Vizita në Institucion], [Takimi me studentët]</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në vizitën në Institucion, në takimin me Pedagogët, GVJ mësoi se në fillim të vitit akademik informojnë studentët me kriteret e vlerësimit të dijeve. Tek rregullorja e Departamentit, dhe në rregulloren e programit të studimeve jepet informacion mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Informacion më i detajuar për secilin modul jepet tek syllabuset e programit të studimeve. <i>[Vizita në Institucion], [Takimi me drejtuesit], [evidencat nr. 3-Plani Strategjik UET 2021-2025, 5-Rregullore UET]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Pedagogët informojnë studentët në lidhje me punimin e diplomës ndërsa institucioni ka hartuar një manual specifik për punimin e diplomës. Në këtë program studimi, studentët nuk hartojnë temë diplome sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesin e Departamentit</p> <p><i>[Vizita ne Institucion],[Takimi me studentët],[Takimi me drejtuesit],</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit akademik institucioni zhvillon takime me qëllim informimin e të interesuarve në këtë program studimi. Organizimi i ditëve të hapura është një procedurë e zakonshme që zhvillon për të tërhequr student të rinj. Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese. <i>[Vizita ne Institucion], [Takimi me studentët],[Takimi me drejtuesit].</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Dokumentat e hartuara nga Institucioni u japin mundësi studentëve të marrin informacionin e nevojshëm mbi përparimin akademik, kreditet e nevojshme, kalimin nga viti në vit, njohjen e studimeve të mëparshme, procedurat e vlerësimit të dijeve si dhe atyre të përpunimit të diplomës. Po ashtu organizon takime të rregullta për informimin e kandidatëve të mundshëm.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

**Standardi V.3**




**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar mbi programin e studimeve, organizimin, kohëzgjatjen etj. Në fillim të vitit akademik ata informohen nga Koordinator i Programit të studimit. Informacion i detajuar po ashtu gjendet tek rregullorja e programit të studimit (neni 23-24) si dhe tek rregullorja e departamentit. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri], [evidenca nr.4. Plani strategjik për këtë programit të studimit të MSH].</i> <i>[Vizita ne Institucion], [Takimi me studentët], [Takimi me drejtuesit].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabus-e studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të mësimit (leksion, seminar, praktikë). <i>[evidencat nr. 14.2-Plani mësimor i programit]</i> <i>[evidencat nr. 14.1-Kurrikula e programit MSh Infermieri]</i> <i>[evidencat nr. 19-Silabuse shqip]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin në Institucion, GVJ konstatoi se UET ka në strukturën e vetë Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni e cila organizon aktivitete të ndryshme për orientimin e studentëve në tregun e punës. <i>[vizita në institucion], [takim me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik koordinatori i programit të studimeve informon studentët mbi organizimin e studimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme. Secili pedagog informon studentët mbi modalitetet e secilës lëndë që ata zhvillojnë ndërsa sekretaria mësimore pajis me email si dhe kodet personale për secilin për akses në systemin e Universitetit. Pranë sekretarisë marrin shpesh herë po ashtu edhe informacion mbi sallat e ndryshme dhe infrastrukturën e Njësisë Kryesore.  <i>[evidencë 14]; [evidencë 48];</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UET ka ndërtuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili funksionon në distancë. Studentët dhe pedagogët kanë mundësi ta aksesojnë atë nga vendi ku ata ndodhen. Studenti dhe pedagogu disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në cdo moment.</p> <p><i>[Vizita në institucion], [Takimi me drejtuesit]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se Institucioni u vë në dispozicion studentëve informacion për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve. Pralelisht, nga koordinatori i programit të studimeve ata marrin informacion të detajuar mbi studimet dhe detyrimet e tyre. Vihet re që ka një procedurë të caktuar për mundësitë e punësimit të studentëve, por duhet të shihet mundësia për të punësuar studentë që mbarojnë në FSHMT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka të dhëna statistikore mbi numërin e studentëve si dhe atyre të diplomuar në këtë program studimi. Ky informacion është i disponueshëm nga sekretaria mësimore. Përdorimi i UIMS ndihmon në përgatitjen e këtyre statistikave. Të dhënat janë të mundshme përmes 1) regjistrit themeltar të studentëve, regjistrit të lëshimit të diplomave dhe regjistrit me arritjet akademike (regjistri i notave). Krijimi i një sektori specifik (ose një person përgjegjës) për të mbajtur dhe për të përditësuar të dhënat statistikore do ishte e nevojshme.</p> <p><i>[Takimi në sekretarinë mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi,</p>	<p>Institucioni përmes sistemit UIMS ka të mundshme hartimin e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit deri në momentin që ata diplomohen. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër</p>

<p>si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit. Numri i studentëve për vitet e fudnit akademike është si më poshtë: 2022-2023 48 studentë 2023-2024 94 studentë 2024-2025 130 studentë <i>[Takim me sekretarinë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Përdorimi i sistemit LMS mundëson menxhimin e të dhënave statistikore. Secili nga përdoruesit ka nivele të ndryshme aksesit në bazë të funksionit të vetë si dhe duke ruajtur konfidencialitetin.  <i>[evidenca nr. 46,1 Mbi punën e platformave LMS]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Kontrolli periodik është i mundur nga instancat përgjegjëse në Institucion. Në Statutin e UET janë të përfshira funksionet e autoriteteve drejtuese ku përmenden edhe detyrat kontrolluese të tyre. Dekani i FSHMT ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit (Kompetencat mbi kontrollin periodik përfshihen të detajuar në rregulloren e UET . Institucioni po ashtu ka hartuar një dokument specifik mbi krijimin, ruajtjen, shërbimin dhe dorëzimin e dokumentave në UET. <i>[evidenca nr.43-Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit DIF 21-24]</i> <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet përpilohen në formën e analizës, e cila bëhet një herë në dy tre vjet (<i>sipas asaj që referon drejtuesja e dep</i>). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga komunikimi me Institucionet e tjera vendore. Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesit e FSHMT, GVJ kërkoi informacion mbi licensimin dhe punësimin e studentëve.  <i>[Takim me Dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit. Institucioni ka të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve si dhe atyre të diplomuar në këtë program studimi. Përdorimi i sistemit</i></p>

	<i>të brendshëm asiston në këtë objektiv. Kontrolli periodik është i mundur nga instancat përgjegjëse në Institucion ndërsa në raportin vjetor përfshihen informacione mbi cilësinë e studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në vizitën në Institucion, GVJ në takim me Studentët, mësoi se ata janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë një rregullore të këshillit studentor. Gjatë takimit me studentët ata deklaruan se kontaktojnë zakonisht me anëtarët e organeve të tyre për problematika të ndryshme.  <i>[Takimi me studentët]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët raportuan se ata janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë një rregullore të këshillit studentor. Gjatë takimit me studentët ata deklaruan se kontaktojnë zakonisht me anëtarët e organeve të tyre për problematika të ndryshme. Evidentimi i përfshirjes së studentëve në vendimmarrje ishte i qartë.  <i>[Takimi me studentët]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në	Institucioni raporton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit mësimor. Studentët përbëjnë një nga grupet kryesore të interesit. Ata plotësojnë pyetësin e hartuar nga SBC në mënyrë të rregullt dhe sugjerojnë përmirësime. Sipas takimit me studentët, ata ishin përfshirë në procesin e përmirësimit të programit të studimit.

mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<i>[Takimi me studentët]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Rregulloren e FSHMT si dhe rregulloren e Departamentit, studentët kanë të drejtë të ankohen në rast se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, duke iu drejtuar Dekanit të fakultetit. Dekani vlerëson ankesën dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Në rast se, nga shqyrtimi i ankimit, vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e Rregullores, me propozimin e drejtuesit të DSTM, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit dhe për ridhënien e provimit ose kolokiumit brenda ditës ose të nesërmen. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të DSTM me një ankesë me shkrim. Drejtuesi i DSTM vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe ngarkon komisionin me aktin përkatës. <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i> <i>[Takimi me Dekanin, takimi me studentët]</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, Studentët janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët po ashtu kanë një rregullore të këshillit studentor. Nuk u paraqit dokumentacion mbi aktivitetet të këshillit studentor. Institucioni raporton se studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit ndërsa studentët raportuan se nuk ishin përfshirë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Studentët kanë mundësi të ankimojnë vlerësimin nga pedagogu.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

#### Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ofron informacion studentëve për çështje të ndryshme që ata mund të kenë. Studentët mund ti drejtohen për info tek “Departamenti” ndërsa në faqen zyrtare të Institucionit ata informohen mbi çështje të ndryshme si dhe aktivitete që zhvillohen. Studentët po ashtu kanë mundësi të marrin informacion pranë sekretarive mësimore si dhe pranë Drejtuesit të Departamentit. Në takimin me studentët ata raportuan që marrin informacionin që nevojitet në përgjithësi dhe nga sekretaria. Gjithashtu ata thanë që shumë nga informacionet i gjejnë në faqen zyrtare te UET. <i>[evidenca 6. Dokumenti F.IV-FV Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit] [takimi me studentet].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në vizitën në institucion konstatuam që është i ngritur një sistem për informimin. Aksesit është në varësi të nivelit. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, arritjet akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Sekretaria mësimore ka në formë shkrese a) regjistrin themelatorë të studentëve, b) regjistrin me të dhënat akademike si dhe c) regjistrin e lëshimit të diplomave. Paralelisht, informacion i studentëve gjendet dhe pranë sekretarisë mësimore për secilin student. <i>[takimi me sekretarinë] [evidencë 47]; [evidenca nr.9. Dokumenti EI Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>Në takimin që patëm me Zyrën/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës, kontaktuam që kjo njësi kryen siç duhet informimin e studentëve dhe orientimin e tyre në tregun e punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës raportoi që e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Gjithashtu ata raportuan që Zyra e karrierës organizohet me persona, të cilët kanë orare të shpallura të pritjes së studentëve. Në të njëjtën kohë kontaktet e personave që këshillojnë janë publikë. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të</p>




tjera dhe orientimin në tregun e punës.	cilët komunikon vazhdimisht (email - list), gjë që u konfirmua dhe nga studentët. <i>[evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ZKK raporton që ka ndërtuar një mënyrë komunikimi dhe informimi me studentët, përmes të cilës ata mund të gjejnë orare, pedagogë dhe rregulla të hyrjes dhe qëndrimit në klasë, si dhe t'i orientojnë në: a. aplikimin online për bursat. Zyra e Këshillimit të Karrierës raporton se zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Zyra e karrierës organizohet me orare të shpallura të pritjes së studentëve. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht (email - list) <i>[evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, se Institucioni ofron informacion studentëve për çështje të ndryshme që ata mund të kenë. Një sistem i menaxhimit është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Sektori i këshillimit të karrierës dhe alumni zhvillon aktivitete të ndryshme për maturantët si dhe organizon aktivitete të ndryshme trajnuese për studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni raporton se pedagogët gjatë mësimdhënies përdorin metoda të ndryshme inovative. Në vizitën e zhvilluar në ambientet e fakultetit, laboratorit i anatomisë i jepte mundësinë studentëve zhvillimin e një leksioni modern falë pajisjeve. Paralelisht, Institucioni nxit mobilitetin e pedagogëve jashtë vendit përmes programit ERASMUS+ me qëllim mësimdhënien dhe trajnimin në metoda inovative. Gjatë takimit me pedagogët ata raportuan përdorimin e metodave të ndryshme përfshirë këtu diskutimet, role-play, öorking groups, përdorimin e metodave interaktive etj., në leksionet që ata zhvillojnë. Pavarësisht përpjekjeve, ka një mungesë të një udhëzuesi specifik nga Institucioni për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. <i>[evidenca nr 28.1.1. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta], [Takimi me stafin akademik], [Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Implementimi i pyetësorëve u jep studentëve mundësinë të vlerësojnë pedagogët në mësimdhënie me qëllim vlerësimin e përdorimit të metodologjive inovative. Sipas takimeve të zhvilluara, Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Bazë, vlerëson rregullisht performancën e pedagogëve por nuk ka mekanizma dhe raporte specifike për këtë çështje. Gjithashtu institucioni raporton që në vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të përfshihen dhe metodologji të tjera përfshirë këtu vetëvlerësim i pedagogut, fokus-grupe si dhe pilotim të metodave të ndryshme të reja para se të implementohen në të gjithë Institucionin. <i>[evidencat 30.5-vlerësimin nga drejtuesit e njësisë kryesore/bazë dhe grupeve. [evidenca nr. 30.16-G-III-4-Iformulari i vlerësimin të pedagogut nga eprori-kolegu]</i></p> <p><i>[evidenca 41.1-shembull i formularit të vetvlerësimin të performancës i plotësuar]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni implementon rregullisht pyetësorin për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Në bazë të rezultateve, implementon masa të ndryshme të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Studentët përmes përfaqësuesve të tyre kanë mundësinë të raportojnë problematika të ndryshme. GVJ sugjeron që institucioni në bazë të rezultateve të pyetësorit NJSBC në bashkëpunim me strukturat e tjera të hartoj një plan masash të matshëm dhe ta implementoj atë.</p>




	Paralelisht, propozon dhe metoda alternative të vlerësimit nga studentët përfshirë këtu edhe fokus grupe.  [evidencë 30.1]			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit bëhen publike duke respektuar të dhënat konfidenciale.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në takimet e zhvilluara u raportua se pedagogët njihen me rezultatet e vlerësimit të pyetësorit. Paralelisht, në mbledhjet që zhvillohen (departament, dekanat) diskutohen praktikat e ndryshme në bazë të raportit. Nuk u raportuan aktivitete apo mekanizma specifike për vlerësimin e rezultateve të marra.  <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësinë Bazë</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, Institucioni raporton se pedagogët gjatë mësimdhënies përdorin metoda të ndryshme inovative. Implementimi i pyetësorëve u jep studentëve mundësinë të vlerësojnë pedagogët në mësimdhënie me qëllim vlerësimin e përdorimit të metodologjive inovative. GVJ sugjeron që institucioni në bazë të rezultateve të pyetësorit të hartoj një plan masash të matshëm dhe ta implementoj atë. Paralelisht, propozon dhe metoda alternative të vlerësimit nga studentët përfshirë këtu edhe fokus grupe.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje	Institucioni përshkruan qartë mbarëvajtjen e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni pjesë e së cilës është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Raportohet se veprimtaria e përgjegjësitet është e fokusuar në zbatimin e drejtëpërdrejtë të procedurave dhe standardeve të

<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>përcaktuara me ligj/aktet nënligjore ose të hartuara nga institucioni i arsimit të lartë ndërsa specialistët kryejnë punën brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave të caktuara nga përgjegjësi. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve organizon pyetësonin institucional dhe pyetësonin vlerësues nga studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UET. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për standartet e Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton, në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>[evidencë 2];</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka në strukturën e vet NJSBC e cila është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Paralelisht, ka ngritur Komisionin e Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton, në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm në nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies. Njësia ka hartuar një rregullore specifike të cilën e zbaton. Bashkëpunorët e jashtëm janë të pranishëm përmes Bordi Këshillimor të Biznesit i ngritur në nivel Institucioni. Po ashtu, pedagogët me kohë të pjesshme të cilët janë personel infermieror bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë sipas nevojave dhe rasteve. <i>[evidencat nr.8-Dokumentit F.VII mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, 30.1- Shembull vlerësimi on-line nga studentët, 30.2-Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të</p>	<p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë. Anëtarët e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ta që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, ekspertiza përqëndrohet në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit. NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të</p>




<p>akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. UET ndjek periodikisht procesin e vlerësimit të jashtë. Institucioni është i akredituar nga ASCAL (për një periudhë 5 vjecare) si dhe programet e studimit janë akredituar ose janë në proces akreditimi. [evidencat nr.8-Dokumenti F.VII mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, 30.1- Shembull vlerësimi on-line nga studentët, 30.2-Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë], [evidencat 30.5-Metodologjia e punës së KSBC-provimet, 30.11-shembull komunikimet dhe shpërndarja e raportit për provimet, 30.12-shembull-relacion për monitorimin e syllabyseve]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UET përdor pyetësorin që plotësojnë studentët për të vlerësuar procesin e mësimdhënies. Në takimin me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni u përmend se UET përdor një formular për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve dhe kërkimin shkencor. Rezultatet e arritura raportohen në raportin vjetor. GVJ nuk arriti të identifikonte indikatorë të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, e për këtë arsye sugjeron që Institucioni të hartojë dhe ti implementojë. Në bazë të rezultateve të hartojë plan masash të detajuar.</p> <p>[Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se në strukturën e vet ka Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni pjesë e së cilës është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për standartet e Cilësisë. UET ndjek periodikisht procesin e vlerësimit të jashtëm ndërsa nuk u identifikuan indikatorë të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Raporti përfshin analizën e punës mësimore dhe shkencore të departamentit, ngarkesën mësimore, arritjet kërkimore të pedagogëve, cilësinë e materialeve mësimore si dhe evidentohen propozime për vitin akademik të ardhshëm. Raporti i përcillet Dekanit të Fakultetit. <i>[evidence 30.12]</i></p> <p>Në raportin e konstatimeve të KSBC, vihet re se: duhet riparë syllabus-i “Praktikë 2 (Msc infermieri)”. Duhet të theksojmë se është vetëm një pedagog që mbulon praktikën. Pavarësisht evidentimit të problematikave, nuk paraqitet një plan masash konkret, për të rregulluar këtë problem.</p> <p><i>[evidence 30.12-shembull-relacion për monitorimin e syllabyseve]</i>  <i>[evidenca nr. 32.1-dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale]</i>  <i>[evidenca nr. 32.1-dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit.</p> <p>Në mbledhjet e departamentit analizohen të dhënat e vlerësimit dhe diskutohet plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Në raportin vjetor të departamentit përfshihet evidentimi i disa çështjeve për vitin akademik pasardhës por nuk paraqitet plan masash.</p> <p><i>[evidenca nr. 32.1-dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies,</p>	<p>UET organizon rregullisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit. Raporti përpunohet dhe nxirren rezultatet/konkluzionet të cilat publikohen. Në bazë të rezultateve Institucioni implementon procedura për përmirësimin e situatës që raportohet në raportin vjetor të Institucionit. Në rregulloren e FSHMT, departamentit, programit të studimeve dhe syllabus-et e pedagogëve parashikohen dhe metoda</p>




<p>vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime 77ocale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi I shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>alternative të vlerësimit përveç provimit për vlerësim. Përfshirja e më shumë instrumentave për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies është e nevojshme.  <i>[evidenca nr.7-Rregullore e programit MSH Infermieri]</i>  <i>[30.1- Shembull vlerësimi on-line nga studentët,]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Alumni merr pjesë përmes Bordit I Tregut të Punës ndërsa pedagogët me kohë të pjesshme të përfshirë në këtë program studimi janë pjesë e alumni dhe rregullisht propozojnë përmirësime dhe rekomandime. <i>[Vizita në Intitucion]</i>. Gjatë takimeve u raportua se Institucioni është duke hartuar instrumenta të reja për të vlerësuar shërbimet ndihmësakademike dhe administrative nga ana e studentëve. Organizimi i një vlerësimi 360<sup>o</sup> është një nga sugjerimet kryesore të GVJ-së. Po ashtu rekomandohet që sugjerimet e stafit me kohë të pjesshme, si dhe bashkëpunorëve të jashtëm të jenë të dokumentuara.  <i>[Vizita në Institucion]</i>.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet periodike të departamentit. UET organizon rregullisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit. Përfshirja e më shumë instrumentave për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies është e nevojshme si dhe i një vlerësimi 360<sup>o</sup>.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Istitucioni ka ngritur Komisionin i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - KSBC. KSBC ngrihet në nivel universiteti; anëtarët e tij propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Secili anëtar i KSBC përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar [evidencë 30.1]. Raport i Përmbledhës i Vlerësimit përgatitet nga Kryetari i KSBC-së ose anëtarë të deleguar prej tij. Kompetencat profesionale. [evidencë 30 2.1].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjithë aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë kanë funksione dhe detyrime të përcaktuara qartë në rregullat e brendshme të Institucionit. Funksionet dhe kompetencat pasqyrohen në Rregulloren e Institucionit, përcakton funksionet dhe kompetencat Ndjekja e vazhdueshme e zhvillimit të programeve të studimit, hartimit të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit dhe përditësimit të tyre, si dhe monitorimi i të gjitha proceseve të tjera që kanë të bëjnë me detyrimet akademike të studentit, nga regjistrimi deri në diplomim (vlerësimi i syllabus-eve, cilësia e korigjimit të provimeve, etj). Monitorimi i vazhdueshëm i nivelit të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik dhe ndihmës, përmes vlerësimit nga studentët (pyetësorë, focus grupe, etj.), si edhe kualifikimit të tij, përmes të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së veprimtarisë kërkimore shkencore në institucion. Monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe veprimtaritë e përditshme të institucionit.</p>

	<i>[evidencë 8] F.VII.4.3. F.VII.4.4. F.VII.4.5</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë SBC-së raporton se bën monitorimin e vazhdueshëm të drejtimit të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloren dhe aktet e tjera rregullatore të UET, të hartuara në përputhje me filozofinë dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. <i>F.VII.4.2.</i> Ndjekja e vazhdueshme e zhvillimit të programeve të studimit, hartimit të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit dhe përditësimit të tyre, si dhe monitorimi i të gjitha proceseve të tjera që kanë të bëjnë me detyrimet akademike të studentit, nga regjistrimi deri në diplomim (vlerësimi i syllabus-eve, cilësia e korigjimit të provimeve, etj).
	<i>[Takimi me Drejtuesin e Departamentit]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Të gjithë anëtarët e stafit akademik si dhe studentët kanë të drejtë pa përjashtim të kandidojnë dhe të zgjidhen, <i>[evidencë 2]</i> . Kjo shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie të mundshme. Stafi i UET është i detyruar të respektojë kodin e etikës së miratuar nga Institucioni. <i>[evidencë 5]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë diskutimeve me stafin akademik si dhe me SBC u raportua përfshirja e aktorëve të jashtëm për sigurimin e cilësisë. Ngritja e Bordit Këshillimor të Biznesit ndihmon në procesin e përmirësimit të cilësisë. Aktorë të jashtëm në FSHMT janë zakonisht pjesë e alumni dhe që punojnë si staf i spitaleve ose qëndrave shëndetësore dhe të përfshirë në praktikën mësimore. <i>GVJ nuk evidentoi aktivitetet të tilla.</i>
	<i>[Takimi me Stafin Akademik]</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ referon se UET ka ngritur Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë si në nivel Institucioni ashtu dhe në nivel Njësie Kryesore. Stafi akademik dhe studentët janë të përfshirë si anëtarë të këtyre komisioneve të cilat kanë detyra dhe</i>

	<i>funksiione të caktuara. GVJ propozon dokumentimin e përfshirjen dhe rekomandimet e aktorëve të jashtëm.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UET publikon raportet e pyetësorëve të studentëve rregullisht në faqen zyrtare të vet. Paralelisht, publikon strategjitë e rregulloret e ndryshme si dhe aktet e brendshme të cilat lidhen me sigurimin e cilësisë. Në këto dokumenta studentët si dhe të gjithë të interesuarit kanë akses. Me qëllim transparencën dhe informimin pa dallim. <i>[evidence 30.1]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e pyetësorëve të studentëve bëhen publike nga Institucioni. Po ashtu, informacion lidhur me sigurimin e cilësisë përfshihet në raportin vjetor të UNIEL i cili është publik. I gjithë informacioni që publikohet respekton lirinë dhe etikën profesionale duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale. Kodi i etikës së Institucionit përcakton qartë të dhënat që mund dhe ato që nuk mund të publikohen.  <i>[evidencë 30.1. Shembull vlerësimi online nga studentet]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti i analizës së pyetësorëve përfshin disa përfundime dhe rekomandime në bazë të rezultateve. GVJ nuk arriti të evidentonte një plan masash konkret me objektivat specifike, afatet kohore, strukturat e nevojshme etj. GVJ sugjeron hartimin e planit të masave me qëllim vlerësimin afatmesëm dhe afatgjatë të arritjeve.  <i>[30.1- Shembull vlerësimi on-line nga studentët]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Komisionet në nivel Institucional dhe nivel Njësie Kryesore vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme këtë proces. Në bazë të kuadrit ligjior, Njësia Bazë ka mundësinë të propozoj riorganizim

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	të programit deri në masën 20%. [evidencë13], [evidencë14]. Ato ndryshime i përcillen Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit (nëse ka efekte financiare) për miratim. Pyetësorët që organizon institucioni është një metodë për monitorimin e vlerësimit e cilësisë. <i>GVJ rekomandon dokumentimin e tyre që lidhen me përmirësimin e cilësisë së programit të studimeve.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Një nga rolet kryesore të KSBC është informimi rregullisht i pedagogëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. SBC mbështet dhe ofron ekspertizë. Anëtarët e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ta që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, ekspertiza përqëndrohet në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënësve. Gjatë takimit me pedagogët dhe strukturën e SBC ata raportuan se zhvillojnë rregullisht takime me qëllim informimin e stafit akademik dhe studentëve  [evidencë 30.1, [evidencë 30.5]			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, se UET publikon raportet e pyetësorëve të studentëve rregullisht në faqen zyrtare të vet. Paralelisht, publikon strategjitë e rregulloret e ndryshme si dhe aktet e brendshme të cilat lidhen me sigurimin e cilësisë. GVJ sugjeron hartimin e planit të masave me qëllim vlerësimin afatmesëm dhe afatgjatë të arritjeve. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. **Organizimi i programit të studimit.** Programi i studimit MSH në “Infermieri” është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë. Gjithashtu ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe me aktet rregullatore të institucionit. Ky program është i strukturuar në mënyrë të tillë që studentët të marrin gjithë informacionin e nevojshëm teorik e shkencor si dhe aftësitë praktike të thelluara për t’iu përshtatur objektivave formues të profesionit të infermierit dhe tregut të punës.
2. **Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe praktikat klinike.** UET siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore e shëndetësore si dhe me kompani e palë të treta në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor e mobilitetit.
3. **Mësimdhënia.** Metodot e mësimdhënies, me në qëndër studentin, synojnë zhvillimin e aftësive kritike dhe të pavarura të tij dhe e orientojnë studentin të analizojë situata mjekësore, të marrë vendime të sakta dhe të sigurta dhe të aplikojë teorinë në praktikë, të zhvillojë aftësi praktike dhe u mundëson atyre të ofrojnë kujdes shëndetësor cilësor.
4. **Informatizimi i sistemit.** Sistemi LMS ofron mundësinë për akses të vazhdueshëm në leksione, literaturë, syllabuse dhe komunikim me pedagogët. Po ashtu, informatizimi i sistemit në nivelin e sekretarisë dhe koordinatores së programit ndihmon në menaxhimin e procesit mësimor dhe në informimin e studentëve për proceset e vazhdueshme.
5. **Kontrolli i dijeve.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në këtë program. Kontrolli dhe vlerësimi i vazhdueshëm i dijeve është një metodë shumë efikase që nxit angazhimin e studentëve dhe garanton cilësi më të lartë në rezultatet e tyre.

**Pika të dobëta**

1. **Mungesa e stafit efektiv me formim infermieror.** Pavarësisht faktit që titullarët e shumicës së lëndëve karakterizuese të programit janë mjekë profesionistë të fushave përkatëse dhe të pajisur me tituj dhe grada shkencore, shumica e këtyre lëndëve, që natyrisht, janë me karakter infermieror, nuk ka titullarë me formim infermieror. (**Standardi III.1, Kriteri 4**)



2. **Mangësi të literaturës në gjuhën shqipe.** Pavarësisht se kriteri themelor në përzgjedhjen e literaturës është të jetë e 5 viteve të fundit dhe nga botime të shtëpive botuese prestigjioze, vihet re mangësi në literaturë në gjuhën shqipe duke patur parasysh faktin që është gjuha zyrtare e programit. (**Standardi II.4, Kriteri 5**)


### **Rekomandime**

1. Është e domosdoshme të rekrutohet staf me formim infermieror me grada e tituj për udhëheqjen e lëndëve me karakter infermieror.
2. Të merren masa për sigurimin e literaturës së përditësuar në gjuhën shqipe.
3. Departamenti duhet të sigurojë përputhjen e cdo syllabusi me planin mësimor lidhur me shpërndarjen e veprimtarive formuese, si dhe specifikimin e qartë të literaturës së detyruar me nr faqeje. (në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.1.2018)
4. Analiza e punës së departamentit duhet të jetë e përvitshme dhe e protokolluar (neni 32 i Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri)
5. Të përditësohen CV-të e stafit që angazhohet në këtë program studimi.
6. Duhet që lista e marrëveshjeve të përditësohet dhe po ashtu nevojitet përditësimi i një pjese të dokumenteve rregullatore të institucionit.
7. Rregullorja duhet të publikohet edhe në ëbsite të Institucionit.
8. Mospërputhje midis planit mësimor dhe syllabuseve dhe mangësi në formatimin e syllabuseve. Vihet re një mospërputhje midis planit mësimor (në të cilin nuk ka laboratore) dhe syllabuseve të disa lëndëve që kanë rubrikën laboratore në veprimtaritë mësimore. Literatura e detyruar nuk është e detajuar me numrin e faqeve për çdo temë në të gjitha syllabuset.
9. Mungesa e përditësimit të disa dokumenteve me rëndësi: statutit, manualit për sigurimin e cilësisë, një pjese të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe një pjese të CV-ve të stafit.
10. Analizimi i punës së departamentit dhe programit të studimit në mënyrë periodike, duhet të bëhet për cdo vit akademik. Sipas nenit 32 të ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë, citohet që IAL duhet të paraqesi çdo vit akademik raportet vjetore.

### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Nursing" provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana"**

#### **Strengths and affirmations**

1. **Organization of the study program:** The study program Master of Sciences in "Nursing" is detailed, informing, structured and organized program in accordance with the forming objectives of programs of second cycle. This program is organized in accordance with the



national laws and regulations and the institutional regulations of the institution. The structure of the program allows the students to obtain all the necessary theoretical information and practical skills to adopt to the forming objectives of nursing profession and the actual job market.

2. **Collaboration agreements and clinical practice.** European university of Tirana ensures collaborative agreements with educational and health institutions, and third-party companies in order to fulfill the competition of the study program so that the students acquire professional skills, scientific research and mobility.
3. **Teaching.** Student centered teaching methods aim to develop critical and independent thinking skills, and orient the students to assess medical situations, to take exact and safe decisions, and to implement theoretical knowledge into practice, to develop practical skills and to offer quality health care.
4. **System informatization:** LMS system offers the possibility for ongoing access in lectures, literature, learning plans and communication with the pedagogues. Furthermore, this system in the level of secretariat and the program coordinator helps in the management of the education process and the formation of students for further education processes.
5. **Knowledge control.** The institution enables students of the study program to obtain fully detailed information on the academic process, knowledge control till the end of the studies and graduation from this program. The ongoing evaluation process of students' knowledge is a very efficient method that promotes student engagement and guarantees higher quality of their results.

## Weaknesses

1. **Lack of full-time staff in the profile of nursing.** Regardless the fact that the official subject lecturers in most of the characterizing subjects are professional doctors from respective fields and hold scientific titles and diplomas, most of these subjects are nursing oriented, so nurses should be responsible for these subjects **Standard III.1, Criteria 4**
2. **Lack of Albanian language literature.** We noticed that the main criteria for literature selection are to be published within the last 5 years from the well-known publishing houses, but there is reality, is a lack of Albanian language literature, keeping in mind that the official language for this program is Albanian language. **Standard II.4, Criteria 5**

## Recommendations

1. It is necessary to recruit staff with nursing education with degrees and titles to teach nursing classes.
2. The institution should ensure that the literature in the Albanian language is updated.



3. The department should ensure that each syllabus complies with the curriculum regarding the distribution of forming activities, as well as the clear specification of the required literature with page numbers. (in accordance with MCD no. 41, dated 24.1.2018)
4. The analysis of the department's work should be annual and documented (Article 32, Law 80/2015 on Higher Education in Albania)
5. The staff involved in this study program should update their CVs.
6. The list of agreements with other institutions should be updated; some of the regulatory documents of the institution should be updated too.
7. The institution regulation needs to be published on the website of the Institution.
8. Inconsistency between the curriculum and syllabus and deficiencies in the formatting of syllabuses. There are discrepancies noted between the curriculum (without laboratories) and the syllabuses of some subjects that have a laboratory section in the teaching activities. The required literature is not detailed with the number of pages for each topic in all syllabuses.
9. The lack of updating some of the most important documents: Statute, manual for quality assurance, some of the agreements and some of staff CVs.
10. Analyzing the work of the department and the study program periodically, but not for each academic year. According to article 32 of Law 80/2015 on Higher Education, it is stated that Higher Education Institutions must submit annual reports every academic



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X